

1 E hënë, 21 tetor 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 13.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare, e seancë, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar

8 Gjykatës, kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i

9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep

10 Selimit, dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 Mirëdita. Për procesverbal të gjithë të akuzuarit janë të

13 pranishëm në seancën e gjyqit. Gjykatësi Barthe do na ndjekë

14 përmes videolidhjes për arsye personale.

15 Sot do të fillojmë me dëshminë e Dëshmitarit të

16 Prokurorisë W04240.

17 Përpara sesa të fillojmë dua t'ju kujtoj që sot do të

18 kemi një pushim nga ora 2.30 deri në orën 3.00 dhe pastaj do

19 të vijojmë me seancën e fundit nga ora 3.00 deri në 4.30.

20 Përveç kësaj kam edhe një sqarim për procesverbal. Trupi

21 Gjykues vëren se prova materiale 1D00188 gabimisht është

22 caktuar dy herë. Së pari, ka marrë numrin e provës U01-4078

23 deri në U001-4080/U001-4078-U001-4080-ET, që është shënuar për

24 identifikim me 4 shtator 2024 si prova 1IT-100188 [Sipas

25 përkthimit]. I referohem këtu transkriptit në faqet 19682 deri

1 në 19629.

2 Së dyti, dokumenti SPOE003055948 është pranuar si provë
3 me 16 shtator 2024 dhe ka marrë numrin e provës 1D0188 në
4 transkript në faqen 19732.

5 Trupi Gjykses autorizon Njësinë për Administrimin e
6 Gjykatës që të caktojë numrin pasues që është i disponueshëm
7 si provë për faqen SPOE0035

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] SPOE003059-48.

9 Trupi Gjykses do të caktojë pranimet për 1D00188 MFI kur
10 t'i vijë momenti.

11 Sekretare, ju lutem, caktoni këtë numër.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po, të nderuar
13 Gjykatës, faqja me numër ERN-je SPOE00305948 që më përpara
14 është pranuar si 1D00188, tani do të marrë një numër të ri të
15 provës materiale, përkatësisht 1D00195. Faleminderit.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

17 Znj. Sekretare e seancës, ju lutem, nga kaloni në seancë
18 private në mënyrë që të mbrojmë identitetin e dëshmitarit.

19 [Seancë private]

20 [Seancë private teksti i fshirë]

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8 [Seancë e hapur]

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
10 tani jemi në seancë publike. Konfirmoj që masat mbrojtëse janë
11 hequr dhe nga tani e në vijim dëshmitari do të dëshmojë pa
12 shtrembërim zëri dhe figure.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

14 Tani Asistentja e seancës do t'ju japë tekstin e betimit
15 solemne që duhet që ta lexoni në pajtim me rregullën 141(2) i
16 Rregullores.

17 Ju lutem, hidhini një sy një herë dokumentit dhe pastaj
18 lexojeni me zë atë.

19 DËSHMITARI: [E padëgjueshme].

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Lexojeni me
21 zë.

22 DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime
23 dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të
24 them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën, dhe
25 nuk do të mbaj të fshehur asgjë për të cilën kam dijeni.

1 DËSHMITARI: FADIL GECI

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
3 Dëshmitar. Tani mund të uleni.

4 Dëshmitar, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj që
5 parashikohet që të zgjasë përafërsisht dy ditë. Sikurse mund
6 ta dini e para do t'ju bëjë pyetje Prokuroria. Pas Prokurorisë
7 edhe ekipet e Mbrojtjes kanë të drejtë t'ju bëjnë pyetje, si
8 dhe anëtarë të Trupit Gjykes mund t'ju bëjnë pyetje.

9 Prokuroria ka vlerësuar që i duhen dy orë për t'ju marrë
10 në pyetje. Ekipet e Mbrojtjes kanë vlerësuar që i duhen
11 gjithsej shtatë orë. Sikurse edhe në raste në tjera ne
12 shpresojmë që secila prej palëve do jetë efikase sa i takon
13 përdorimit të kohës. Trupi Gjykes mund të lejojë pyetje
14 plotësuese nga ZPS-ja në qoftë se përmbushen kushtet
15 përkatëse.

16 Ju lutem, Dëshmitar, dëgjoni pyetjet dhe jepni përgjigje
17 me fjali të shkurtra dhe të qarta. Në qoftë se nuk e kuptoni
18 pyetjen lirisht mund t'ju kërkoni avokatëve përkatëse që ta
19 perifrazojnë ose t'ja u sqarojnë pyetjen. Po ashtu, ju lutem,
20 na thoni se cila është baza e njohurive, fakteve dhe
21 rrethanave për të cilat do të pyeteni.

22 Në rast se ZPS-ja ju kërkon që të dëshmoni disa
23 korrigjime që keni bërë për deklaratat tuaja, ju kujtojmë që
24 duhet që të konfirmoni për procesverbal që deklaratat me
25 shkrim sikurse janë korrigjuar nga lista e korrigjimeve

1 përfaqësojnë në mënyrë të saktë dëshminë tuaj.

2 Po ashtu, ju lutem, flisni pranë mikrofonit. Bëni një
3 pauzë prej pesë minuta përpara se të jepni përgjigje për
4 pyetjen dhe pastaj duhet të flisni ngadalë në mënyrë të tillë
5 që t'ju kapin përkthyesit.

6 Gjatë ditëve që do të jepni dëshmi në këtë Gjykatë, nuk
7 lejoheni që të diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë suaj
8 jashtë sallës së gjyqit. Në qoftë se ndonjë person vjen për
9 t'ju bërë pyetje që është dikush që nuk është pjesë e
10 Gjykatës, ju lutem duhet të na informoni menjëherë lidhur me
11 këtë.

12 Nëse ju kërkoj të mos flisni më, duhet të mos flisni më.
13 Po ashtu, në qoftë se shikoni që ngre dorën, nuk duhet të
14 flisni më. Kjo do të thotë që unë duhet t'ju jap disa
15 udhëzime.

16 Në qoftë se e ndjeni të nevojshme se keni nevojë për
17 pushime, na e thoni këtë gjë dhe ne do të bëjmë organizimet
18 përkatëse.

19 Do të fillojmë së pari me pyetjet e Prokurorisë.
20 Prokuroria është ulur në të majtën tuaj. Ju lutem, dëgjojeni
21 me vëmendje.

22 Z. Pace, fjala për ju.

23 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

24 Pyetje nga z. Pace:

25 Z. PACE: [Përkthim]

1 PY. Mirëdita, Dëshmitar.

2 PË. Mirëdita. Përshëndetje.

3 PY. Ne jemi takuar dhe më herët, megjithatë do prezantohem.

4 Unë jam James Pace, Prokuror me Prokurorinë dhe sikurse e tha
5 dhe Gjykatësi unë do t'ju bëj pyetje për rreth dy orë.

6 Përpara sesa t'ju bëj pyetje lidhur me hollësitë tuaja
7 personale, e di që sikurse e kemi shpjeguar në seancën
8 përgatitore përpara një jave, në vend që t'ju bëj pyetje
9 lidhur me çdo temë për të cilën ju mund të keni informacion,
10 mund të jetë e mundur që të pranohet dëshmia e mëhershme e
11 juaja që përmban këtë informacion. Dhe në mënyrë që ta bëjmë
12 këtë gjë, do të duhet që të ndjekim disa aspekte procedurale,
13 të cilat unë do t'i ndjek pasi t'ju kem pyetur emrin dhe
14 mbiemrin.

15 Si quheni, Dëshmitar?

16 PË. Fadil Geci.

17 PY. Cila është datëlindja juaj?

18 PË. 19.03.1961.

19 PY. Çfarë shtetësie keni, Dëshmitar?

20 PË. Kosovare.

21 Z. PACE: [Përkthim] Dëshiroj t'i tregohet dëshmitarit,
22 dokumenti 05034-TR-ET [Sipas përkthimit] Pjesa 1 RED2. Dua që
23 të paraqiten të dyja versionet në shqip dhe në anglisht, dhe
24 versioni në shqip përfundon me ERN dhe -AT në fund. Faqja e
25 parë e të dy dokumenteve, ju lutem, në ekran.

1 PY. Dëshmitar, a shikoni dy dokumente në ekranin që keni
2 përpara? Në të majtë është në shqip dhe në të djathtë në
3 anglisht. Sikurse mund ta shikoni, thuhet në krye të
4 dokumentit që kjo është intervistë që ju i keni dhënë ZPS-së
5 me datën 18 shtator 2018. A ju kujtohet të jeni takuar me
6 Prokurorin në këtë datë dhe në datat pasuese, ditët pasuse,
7 Dëshmitar?

8 PË. Po, është e vërtetë që jemi takuar.

9 Z. PACE: [Përkthim] Për procesverbal, ky dokument edhe
10 dokumente të tjera që do të përdor gjatë marrjes në pyetje të
11 dëshmitarit, mund të transmetohen për publikun. Për
12 procesverbal intervista juaj përmban tetë pjesë.

13 PY. A ju kujtohet, Dëshmitar, që keni bërë disa sqarime dhe
14 korrigjime mbasi e keni rishikuar edhe një herë deklaratën që
15 i keni dhënë më herët Prokurorisë, pra më përpara një jave a
16 keni bërë disa ndryshime në deklaratën tuaj të mëparshme?

17 PË. Po, kemi bo. Ka qenë gabime me një gërmë që mund t'ja
18 ndërrojnë kuptimin krejt fjalisë.

19 Z. PACE: [Përkthim] Mund t'i hiqni dokumentet nga ekрани,
20 Sekretare.

21 PY. Dëshmitar, a ju kujtohet që sqarimet dhe korrigjimet janë
22 përfshirë në një shënim, në një dokument i cili më pas ju
23 është lexuar juve i plotë, përpara një jave? A ju kujtohet
24 kjo?

25 PË. Po.

1 PY. Duke marrë parasysh sqarimet dhe korigjimet në atë
2 dokument, informacioni që keni dhënë në deklaratat për
3 Prokurorinë a është i saktë dhe i vërtetë me aq sa dini dhe
4 besoni ju?

5 PË. I vërtetë dhe vetëm i vërtetë.

6 PY. Duke marrë parasysh sqarimet dhe korigjimet në atë
7 dokument, deklaratat që i keni dhënë ZPS-së a pasqyrojnë saktë
8 në qoftë se do ju bënë pyetje lidhur me ngjarjet që
9 pasqyrohen në atë dokument?

10 PË. Saktë. Këtu jam për q'atë.

11 Z. PACE: [Përkthim] Dua që të kërkoj pranimin në provë
12 materiale të deklaratës së mëhershme të dëshmitarit që ka tetë
13 pjesë dhe tri prova shoqëruese. Kemi numrat ERN të cilat janë
14 përcaktuar në postën elektronike në mesazhin që kemi dërguar
15 me datë 17 tetor 2021 [Sipas përkthimit] dhe në shtojcën 1 si
16 dhe Shënimi Përgatitor numër 1. Kërkojmë të pranohen këto
17 dokumente që renditen në Shënimin Përgatitor 1 dhe dokumenti
18 123191 deri në 123201.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
20 kundërshtim?

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Përveç kundërshtimit që kemi dhënë
22 lidhur me provat shoqëruese me shkrim, nuk kemi kundërshtime
23 të tjera.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis?

25 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk kemi as ne kundërshtime të

1 tjera.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
3 05034-TR-ET [Sipas përkthimit] të gjitha pjesët, pra të teta
4 pjesët, plus versionet në shqip, RED2, pranohen në prova
5 materiale.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
7 dokumenti me ERN 053034, Pjesa 1, në shqip dhe në anglisht, do
8 të marrë numrin e provës P0141 [Sipas përkthimit]. Pjesa 2 do
9 të marrë numrin P01740.2. Pjesa 3 do të marrë numrin e provës
10 P01740.3. Pjesa 4 do të marrë numrin P01740.4. Pjesa 5 do të
11 marrë numrin e provës P01740.5. Pjesa 6 do të marrë numrin e
12 provës P01740.6. Pjesa 7 do të marrë numrin e provës P01740.7.
13 Dhe, Pjesa 8 do të marrë numrin P01740.8. Të gjitha këto
14 dokumente klasifikohen për momentin si konfidenciale.

15 Z. PACE: [Përkthim] Mund të riklasifikohen si publike.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
17 Riklasifikojini si publike.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
20 123191-123230 -- 201, që është shënimi përgatitor pranohet si
21 provë.

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Shënimi përgatitor që
23 ka numrin -- do të marrë numrin e provës P01741. Aktualisht
24 është i klasifikuar si konfidencial.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Provat

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fadil Geci (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 11

1 shoqëruese do të pranohen pasi janë të rëndësishme.

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Provat shoqëruese, të
3 nderuar Gjykatës, që janë paraqitur nga ZPS-ja janë si më
4 poshtë: 053035 deri në 053047, versioni në shqip dhe përkthimi
5 përkues në anglisht do të marrin -- që kanë numër ERN-je U000-
6 8075 deri në U000-8089 do të marrin numrin e provës P01742.

7 Me sa kuptoj unë ka një faqe shtesë në versionin në shqip
8 që mungon. Edhe këtë kërkoni që të pranohet në provë?

9 Z. PACE: [Përkthim] Po, është e saktë. Edhe në parim
10 është pranuar në vendim, bëhet fjala për faqen U000-8071 deri
11 në U000-8089. Dhe procesverbal dua të them gjithashtu që
12 sikurse e kemi thënë në me email dhe sikurse e kemi thënë edhe
13 në shënimin përgatitor versioni në anglisht i sakti është ai
14 që përfundon me ET Revise.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po. Propozoj që faqja
16 shtesë të ketë të njëjtin numër në origjinal, në shqip dhe në
17 versionin anglisht. Domethënë të marri numrin e provës
18 P01742.1.

19 Prova shoqëruese numër 2 është SPOE00082472 deri në
20 00082472 dhe përkthimi në anglisht që do të marri numrin e
21 provës P01743.

22 Dhe së fundi, prova shoqëruese me ERN SITF00265515 deri
23 në 00265516 do të marri numrin e provës P01744.

24 Të gjitha provat shoqëruese aktualisht janë të
25 klasifikuara si konfidenciale ashtu sikurse dhe shënimi

1 përgatitor.

2 Z. PACE: [Përkthim] Mund të riklasifikohen si publike.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të gjitha
4 provat shoqëruese pranohen për të shkak të kriterit *prima*
5 *facie* që parashikohet në rregullën 138(1) dhe 154.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

7 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në emailin që e
8 përmenda edhe më herët, ZPS-ja parashtroi që do të bëjë një
9 përmbledhje të propozuar për këtë dëshmitar. Nuk kemi marrë
10 kundërshtime, kështu që do të kërkojmë lejen tuaj që ta
11 lexonim përmbledhjen.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
13 vazhdoni.

14 Z. PACE: [Përkthim] Tani kjo është përmbledhja sipas
15 deklaratës së rregullës 154 për këtë dëshmitar.

16 Dëshmitari ka luftuar gjatë luftuar dhe ka pasur
17 pozicione të ndryshme brenda LDK-së, përfshirë këtu edhe poste
18 drejtuese të LDK-së në Skënderaj.

19 Dëshmitari jep informacion lidhur me themelimin e LDK-së,
20 strukturën e saj, anëtarësimin dhe aktivitetet dhe
21 marrëdhëniet ndërmjet UÇK-së dhe LDK-së, përfshirë këtu dhe
22 kërcënimet dhe sulmet nga pjesëtarë të UÇK-së kundër anëtarëve
23 të LDK-së.

24 Dëshmia e dëshmitarit përfshin informacion që ka të bëjë
25 me autorësinë e Komunikatës 59, të Shtabit të Përgjithshëm të

1 UÇK-së në tetor 1998, që e etiketon vëllain e tij, Gani Gecin,
2 bashkëpunëtor dhe si dhe ndikimin negativ dhe pasojat që ka
3 pasur kjo komunikatë mbi të, mbi anëtarë të familjes dhe mbi
4 të tjerët.

5 Dëshmitari gjithashtu jep informacion lidhur me
6 kërcënimet që i ka bërë Hashim Thaçi dhe Rexhep Selimi Tahir
7 Zemajt si dhe informacion lidhur me arrestimin, ndalimin dhe
8 keqtrajtimin e përfaqësuesve të Asamblesë së Kosovës dhe të
9 Kuvendit të Kosovës në ose përreth Qirezit në shtator 1998, si
10 dhe arrestimin, ndalimin, vrasjen, dhe keqtrajtimin e
11 anëtarëve të UÇK-së [Sipas përkthimit] dhe individëve të
12 tjerë.

13 Po ashtu dëshmitari jep informacion lidhur me
14 ndërveprimet ose bashkëbisedimet apo njohurinë që kanë pasur
15 anëtarë të UÇK-së, përfshirë këtu Rexhep Selimin, Hashim
16 Thaçin, Jakup Krasniqin, Sylejman Selimin dhe Samedin
17 Xhezairin [Sipas përkthimit] lidhur me këtë ngjarje.

18 Kjo është përfundimi i përmbledhjes.

19 PY. Dëshmitar, a e njeh një person me emrin Maxhun Smajli?

20 PË. Po, tani e njoh, mas lufte e njoh.

21 PY. A mund të na thoni shkurtimisht kush është ky person?

22 PË. Është një personalitet, një gazetar ka qenë gjatë luftës.

23 Një djalë i mirë. Kaq kam.

24 Z. PACE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të paraqesë
25 në ekran tani dokumentin P00934, që ka përndryshe emrin ERN

1 U003-8815-U003-9043, në faqen e parë.

2 PY. Dëshmitar, përpara sesa t'jua tregoja këtë dokument javën
3 e shkuar, a e ke parë ti këtë dokument apo e ke parë për herë
4 të parë vetëm javën e shkuar?

5 PË. Për herë të parë e kam pa. Nuk e kam pa ma herët.

6 PY. Do t'ju tregoj disa faqe prej këtij dokumenti dhe pastaj
7 do t'ju bëj pyetje lidhur me të.

8 Z. PACE: [Përkthim] Së pari, i kërkoj Sekretare që të
9 paraqesë në ekran versionin në shqip në faqen 8854. Dhe përbri
10 saj të paraqesin dokumentin U003-8854 deri në U003-8855 në
11 faqen 8854. Mund ta zmadhojmë tek pjesa e pamjes, e figurës që
12 kemi aty në versionin në shqip. Faleminderit. Versioni në
13 anglisht mund të qëndrojë në të njëjtin version që e keni
14 tani, ndoshta pak më poshtë që e keni në faqe.

15 PY. Dëshmitar, këtë fotografinë që e keni në ekran, a e
16 njihni? Megjithëse e kuptoj që nuk është shumë e qartë, por
17 duhet t'ju pyes e njihni këtë fotografi?

18 PË. Po, e njoh. Po nuk e di kah e ka marrë, nuk e di. Unë e
19 njof fotografinë, po e njoh, përafërsisht po njihen njerëzit.

20 PY. Në fund të fotografisë thuhet Besim Dajaku, ti vetë, Esad
21 Geci dhe Sami Hajra. Së pari, Esat Geci, a është vëllai juaj,
22 Dëshmitar?

23 PË. Po.

24 PY. A ka marrë pjesë ai në luftimet që përshkruhen në këtë
25 fotografi?

1 PË. Prej ditës së parë, vëllaznit komplet, djemtë e vëllaut
2 komplet kemi qenë në luftë.

3 PY. Po Besim Dajaku, a ka marrë pjesë në luftën e Llaushës?

4 PË. Besim Dajaku gjithë ka qenë në luftë, deri pas lufte kur
5 është vra nga disa forca që tash po dihet kah kanë ardhë. Ka
6 qenë -- ka qenë truproja e Presidentit Rugova.

7 PY. Po Sami Hajra, a ka marrë pjesë në Llaushë në betejën
8 atje?

9 PË. Po.

10 Z. PACE: [Përkthim] Tani le të kalojmë tek faqja tjetër
11 në të dyja versionet, në shqip dhe në anglisht, që është faqja
12 8855. Në versionin në shqip do ju kërkoja që të paraqitet
13 fillimi i faqes, ndërkohë që në versionin në anglisht gjysma e
14 dytë e dokumentit, drejt fundit të faqes.

15 PY. Dëshmitar, unë do të lexoj nga versioni në anglisht
16 ndërkohë që të më ndiqni përmes përkthimit ose mund ta lexoni
17 dhe vetë. Këtu thuhet sa më poshtë lidhur me këtë libër:

18 "Rrugës për në Llaushë takoj njerëz të shumtë të moshave
19 të ndryshme të armatosur që shkonin me ngut, dikush në këmbë e
20 dikush me traktor, disa edhe me kuaj.

21 "Rrugët e fshatit Llaushë janë të mbushura me ushtarë të
22 UÇK-së. Në shpatin jo larg nga Prekazi, në mal në pozicionet e
23 tyre në gjendje gatishmërie takoj Fadil e Esat Gecin, Besim
24 Dajkun dhe Sami Hajrën e disa persona të tjerë të cilët nuk më
25 lejuan të shkoja më tej, ngase më thanë që forcat serbe ishin

1 sprapsur pas qëndresës së Shaban Jasharit në familje. Por
2 fshati vazhdon të mbahet i rrethuar nga forcat e shumta serbe.

3 "Këtu mësova se në familjen Shaban Jasharit në luftë me
4 forcat serbe ishin plagosur dy vajza. Ndërsa në tërheqje një
5 pjesë e forcave serbe në shenjë revolte në fshatin Klinë e
6 Poshtme kanë vrarë Hysen Mangjollin nga Mikushnica, derisa ai
7 shkonte në punë."

8 Autori thotë që është takuar me ju, me Esat Gecin, Besim
9 Dajakun dhe Sami Hajrën, jo larg nga Prekazi. A ka mundësi që
10 kjo fotografia që ne pamë pak më herët të jetë bërë pikërisht
11 në këtë vend, jo larg prej Prekazit, në shpatin jo larg
12 Prekazit?

13 PË. Është e mundshme. Po e nderuara Gjykatë, unë kam pritë,
14 jam një personazh që të gjitha këto proceset e mëdha ja që
15 kanë kalu nëpër Drenicë kanë kalu kah dera jem, kah une. Dhe
16 kam pritur delegacione me qindra brenda ditës, mbarë botës.
17 Dhe as që janë gazetarë, ka shumë, ma vonë i kam marrë vesh që
18 janë gazetarë, kanë shkru të ndryshme, dhe njëri prej tyre
19 është edhe ky, që kam respekt si djalë i mirë, por e kam që --
20 atëherë nuk e kam dit as kush është.

21 PY. Dëshmitar, edhe Shaban Jashari përmendet te kjo pjesa që
22 e lexove. A e dini ju kush ishte ose kush është Shaban
23 Jashari?

24 PË. Shaban Jashari është baba i dy legjendave, i familjes
25 Jashari. Dhe kjo është dhe kjo merret dikur kah sulmin e dytë

1 që o bo te Jasharët, se sulmi i fundit ka qenë fatal, kurse
2 sulmi i dytë ka qenë kjo që ka pas këto telashe që i janë vra
3 ky në Klinë edhe në Mikushnicë. Familjen Jashari është sulmi i
4 dytë. Këtu po e përshkrujke ai gazetari.

5 PY. Mesa dini ju kur ka ndodhur kjo ngjarje e dytë, në çfarë
6 muaji, ju kujtohet?

7 PË. Kjo ka qenë dikund, unë me data i kam thonë në fillim kjo
8 është publike dikund në janar sa ka qenë ajo në janar '98, më
9 duket, q'ashtu ka qenë. Po për data unë jam, muj me gabu në
10 data ato farë, mos po e shihni për --

11 PY. Siç thuhet këtu, ju kujtohet që forcat serbe janë
12 tërhequr nga Llausha për shkak të rezistencës që ka bërë
13 Shaban Jashari dhe familja e tij?

14 PË. E nderuar Gjykatë, këto dy fshatra, Llausha dhe Prekazi
15 çdo herë nuk kemi dit cila po rrethohet. U rrethu Llausha, i
16 kam [E pakuptueshme] Prekazit. Dhe çdo herë kanë qenë thuja të
17 rrethume dyjat kur ka pas ndonjë rast, se u dit që këto i
18 ndihmojnë njëra-tjetrën, i kanë familjet që janë kon të lidhta
19 dhe këtë e kanë bo forcat serbe çdo herë që kanë pa -- kanë
20 tentu me sulmu edhe kanë rrethu edhe Llaushën në pika më të
21 larta. E kanë vëzhdu në përgjithësi.

22 PY. Ju kujtohet që është vrarë Selman -- Hysen Manjollli
23 [Sipas përkthimit] nga forcat serbe?

24 PË. Po, është e vërtetë, tuj u tërhekë. Ai ka qenë tuj shku
25 në punë në fabrikë të municionit dhe është vra. Atëhere ata të

1 tërbum se kanë pësuar humbje edhe nuk kanë -- kanë pas pasoja
2 edhe disa civilë, edhe në mesin e atyne ka qenë edhe ky person
3 që po përmend.

4 Z. PACE: [Përkthim] Të shkojmë te teksti shqip, në faqen
5 8875 dhe përbri të vendosim përkthimin anglisht me numër U003-
6 8875-U003-8875-ET. Anglisht [Sipas përkthimit] në paragrafin e
7 tretë në të majtë po edhe ashtu në anglisht në paragrafin në
8 paragrafin e tretë.

9 PY. Do lexoj në anglisht që i korrespondon asaj që ke në
10 tekst në shqip "Pasi përfundova..." fillon.

11 "Në orën tre e gjysëm, mbasi përfundova së raportuari për
12 ngjarjet e ditës, Hamit Krasniqi më tha të takohem me Fadil
13 Gecin, udhëheq ushtarak i UÇK-së që kërkonte një person të
14 besuar për të kaluar fshatin Dujakë në fshatin Llaushë, tek
15 Lugu i Bajranit [Sipas përkthimit]. Unë e pranova -- në orën,
16 rreth orës 7.30 në fshatin Kërnice, Jashanicë, dhe Rashanicë
17 [Sipas përkthimit] arrita në fshatin Llaushë. Aty më ndaluan
18 disa anëtarë të UÇK-së të cilët pasi kërkuan emrin tim në një
19 listë më pyetën për qëllimin e shkuarjes sime në këtë fshat.
20 Në listë pashë dhe dy emra të lartë të UÇK-së."

21 E njef që -- e di që Hamit Krasniqi e ka thënë këtë?

22 PË. Unë nuk e di Hamit Krasniqi çka i ka thonë gazetarit, por
23 e di që një ndër burrat, e një ndër dashamirët e mëdhenj ka
24 qenë Ismet Rraci. Unë e kam njoft edhe Hamit Krasniqin po
25 ngushtë kam qenë i lidhur me Ismet Rracin, ka qenë kryetari i

1 degës së Klinës, së LDK-së në Klinë. Dhe Ismetit i kam kërkuar
2 që më duhet dikush me bo do lëvizje në atë drejtim. E Ismeti
3 paska bisedu me këta, që tash po e di se kurrë s'e kam dit.

4 PY. Kur thoni "në atë drejtim", e keni fjalën në drejtim të
5 fshatit Dushkajë?

6 PË. Jo, në drejtim të vijës kufitare të Shqipënisë, në Isniq.
7 Unë kam shku në atë lidhjen në atë drejtim. Kufitar me
8 Shqipëri atje në [E pakuptueshme].

9 PY. Kjo pjesë ju përmend juve që kërkonti dikë t'ju ndihmonte
10 për të kaluar në fshatrat e Dushkajës së Gjakovës, kjo ishte
11 një nga fshatrat që t'u desh të kaloje në atë rast?

12 PË. Po ishte njëra prej rrugëve që mujshe me kalu në atë anë,
13 e unë nuk e kam njoft terrenin, e mujshe me has në forca
14 serbe.

15 PY. Që të jemi të qartë, Hamit Krasniqi sipas dijenisë suaj
16 ka marrë pjesë në luftimet e '89-s [Sipas përkthimit]?

17 PË. Dhe një herë, gjithë këta veprimtarë kanë qenë në shërbim
18 të luftës. Gjithë veprimtarët tuj përfshi kryetarin, e
19 anëtarët të gjithë kanë qenë në shërbim të luftës, aq sa kanë
20 pas mundësi, e aq sa kemi pas mundësi. Unë marr veç komunën
21 tem, Skënderaj, dhe prej 63,000 banorëve sa i kemi pas, prej
22 63,000 banorë, i kemi pas të regjistruar në fletore për me votu
23 referendumin kur i kena majt zgjedhjet e para, e të dyta, tri
24 familje kanë qenë që i kemi pas jashtë kontrole.

25 PY. Dëshmitar, e kuptoj që ke gjëra për të thënë, po ju

1 lutem, përgjigjet përmbahuni pyetjeve që u bëj, sepse do t'ju
2 bëj unë pyetje për secilën.

3 Pra, deshët të kalonit, të venit në atë fshat dhe
4 përmendët vendin. Ju kujtohet kur mund të ketë qenë
5 për afërsisht muaji dhe viti?

6 PË. Menjëherë mbas, mbas sulmit të Prekazit, dikund në maj
7 vëllavi jem në fillim të majit, marsi ka qenë, në fillim të
8 majit ka shku në Shqipëri Halili, vëllai i madh, tek Ministria
9 e Mbrojtjes të Ahmet Krasniqit dhe është njëri ndër
10 themeltarët e asaj ministrie atje.

11 PY. Ndoshta s'e kuptuan -- s'e kuptuat mirë pyetjen. Po ju
12 pyes: Ju kërkoni dikë që t'u ndihmonte të kalonit fshatrat që
13 përmendët. Në çfarë muaji apo viti ka ndodhur kjo?

14 PË. Kjo a ndodhur në '98 në maj, në fillim të majit.

15 PY. Autori i kësaj pjese thotë që kur arritët në Llaushë unë
16 ndalua u nga ushtarët e UÇK-së dhe kërkuan emrin e tij në
17 listë. Ju kujtohet që ketë ndodhur një kontroll i tillë,
18 përfshirë dhe në maj '98-s?

19 PË. Po shiqoni, edhe ajo është kon një farë improvizimi sikur
20 po kontrollojmë diçka, po dimë diçka. Ça kena mujt me dit
21 aty?!

22 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoi që këto
23 dy përkthimet të paraqiten si provë. Për procesverbal them se
24 sipas informacioneve tonë, P934 është pranuar vetëm si provë
25 në anglisht. Dua të pranohen edhe dy përkthimet e tjera që

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fadil Geci (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 21

1 përmenda që janë 8854-8855, dhe 8875-8875, dhe sigurisht do
2 t'ju përmbahemi edhe faqeve në shqip me numër P934.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
4 kundërshtim?

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

6 Z. ROBERTS: [Përkthim] As ne nuk kemi.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faqet 8854-
8 8855 dhe 8875 pranohen të gjitha. Këto janë pjesë e U003-8854
9 deri në U003-8855.

10 Z. PACE: [Përkthim] Sa për ta përkthyer [Sipas
11 përkthimit] në shqip, bëhet fjalë për shumë faqe sepse është
12 një libër i tërë. Pra është P934 që është prova me numër U0088
13 [Sipas përkthimit] deri në 9043.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dy përkthimet do t'i
15 shtohen provës materiale me numër P0934.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
17 Vazhdoni.

18 Z. PACE: [Përkthim] Mund t'i hiqni nga ekрани këto
19 dokumente dhe tani dua që të paraqisni në të dokumentin me
20 numër IT-05-87 6D0067. Dhe faqen e parë mund ta mbajmë në
21 ekran. Në fund jepet numri 6D00-0760.

22 PY. Dëshmitar, keni një dokument përpara në ekran. Është në
23 anglisht. Ju lutem të kalojmë në fillim të faqe. Siç mund ta
24 shikoni dokumenti është një intervistë me komandantin Selimi.
25 E keni parë më parë këtë dokument përpara se t'ja u tregoja

1 unë?

2 PË. Është vetëm versioni në anglisht, s'i kam pa këto shënime
3 unë hiç përpara deri tani te ju.

4 PY. Të kalojmë tek anglishtja në faqe që mbaron 0766. Dhe
5 përbri të vendosim tekstin në shqip që është SPO0036459-
6 0030498 [Sipas përkthimit], faqe që mbaron me 467. Të
7 zmadhojmë fillimin e dy faqeve, ju lutem. Faleminderit.

8 PY. Dëshmitar, do të lexoj në anglisht dhe ju mund ta ndiqni
9 në të majtë në shqip dhe do t'ju përkthehet. Në shqip do të
10 filloj nga pika e parë "Cilët njerëz..."

11 Në anglisht do filloj tani. Është një pyetje që i bën
12 intervistuesi:

13 "Cilët njerëz përbënin bërthamën e Prekazit dhe fshatrave
14 të tjerë që më vonë do të merrte strukturë ushtarake dhe do të
15 shtrihej në tërë Drenicën?"

16 Përgjigje:

17 "Grupin e hershëm të luftëtarëve të Prekazit e përbënin:
18 Adem Jashari, Hamëz Jashari, Sahit Jashari, Sami Lushtaku dhe
19 Fadik Kodra. Ishte pra grupi i parë. Ademi ishte nipi i
20 Gecajve të Llaushës. Jetullah Geci, Sejdi Geci, Xhevahir Geci
21 dhe Osman Geci ishin luftëtarët e parë në Llaushë. Ademi ishte
22 nipi i Sejdiut dhe i Jetullahut."

23 Dëshmitar, pyetja që kam për ju është kjo: Mesa dini ju,
24 a është e vërtetë që Ademi, Samiu, Jetullahu, Sejdiu,
25 Xhevahiri ishin ndër ushtarët e parë, luftëtarët e parë?

1 PË. Po. Po është e vërtetë që janë disa që janë ndër parët,
2 po i ka harru Rexha do, që luftëtari edhe para tanë këtyne
3 edhe para Rexhës vetë, është Gani Geci. E ka harru me qëllim
4 sigurisht [E pakuptueshme] po do them gabim ka ashtu diçka, ku
5 me dit ça o bo. E ka lanë anash. Familja Geci, vëllazënit Geci
6 janë një ndër të parët para gjithëve këtyne në tana proceset.
7 Edhe te Adem Jashari, edhe te lufta, edhe te paqja, edhe
8 gjithkund. Jam këtu, le të më pysin, unë ju tregoj.

9 PY. Sa për të qenë të qartë, emrat që lexova, ata kanë marrë
10 pjesë në fakt në luftimet e hershme në Prekaz, por ju po thoni
11 që Gani Geci gjithashtu ishte një ndër luftëtarët e hershëm,
12 kështu?

13 PË. Jo ndër të hershëm, po i pari para tanëve këtyne. Pas
14 Adem Jasharit është e para tani familja Geci. Para të gjithëve
15 këtyne.

16 PY. Pra, Gani Geci ishte i pari dhe emrat e tjerë gjithashtu
17 morën pjesën në luftimet e hershme?

18 DËSHMITARI: Gani Geci [E padëgjueshme].

19 Z. ROBERTS: [Mikrofoni çaktivizuar].

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një minutë.
21 Vazhdoni, z. Robertson [Sipas përkthimit].

22 Z. ROBERTS: [Përkthim] Sa për të qenë të qartë, mbase
23 dëshmitari është i paqartë, sepse nuk e ka të qartë mbase me
24 kë është bërë intervista. Mesa kuptoj unë, mendohet se është
25 intervistë me Sylejman Selimin, kurse ai ndoshta e ka fjalën

1 për dikë tjetër.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund ta
3 sqaroni z. Pace?

4 Z. PACE: [Përkthim] Padyshim. Unë thashë Sylejman Selimi.
5 PY. Dëshmitar, që të jemi të qartë, këtë intervistë e kanë
6 bërë me Sylejman Selimin dhe po ju pyes prapë. Ju po thoni se
7 emrat që përmenda ishin ndër luftëtarët e parë që kanë luftuar
8 në Prekaz dhe se ju po thoni që vëllai juaj ka qenë i pari
9 fare, kështu?

10 PË. I pari fare ka qenë. Sylejmani kushdo të thotë, e ka
11 gabim aty. Kushdo që e thotë, e ka gabim, e shtrembëron
12 historinë. Rren, me një fjalë, turp ka rren. Fakt është kjo që
13 po them unë para këtu.

14 PY. Po vazhdoj të lexoj.

15 "A mund të flitet për pikën e tretë të rëndësishme si
16 bërthamë luftarake në Drenicë për Açarevën?"

17 Dhe Sylejman Selimi thuhet:

18 "Jo fillimisht. Unë isha pjesëtar i grupit që vepronte
19 rreth Ademit dhe kryenim aksione aty ku duhej. Rexhep Selimi
20 jetonte në Klinë, studionte në Prishtinë dhe ishte në lëvizje.
21 Më vonë mund të flitet dhe për Açarevën kur u hapa me Hysni
22 Shabanin tek i cili i strehoja armët. Pastaj u zgjerova me
23 Avni Haxhën dhe të tjerë. Ky grup rritej vazhdimisht deri në
24 13 persona të organizuar si UÇK bënin rojën e fshatit.

25 "Unë isha gjithnjë pranë tyre. I udhëzoja dhe i ndihmoja.

1 Dita-ditës shtoheshin ushtarë dhe organizoheshin, derisa
2 arritën të bëhen njësi ushtarake e rregullt në kuadër të
3 Brigadës 113 të cilën e komandonte Mujë Krasniqi.”

4 Dëshmitar, pyetja është kjo: Në '98 a e keni ditur apo
5 keni dëgjuar ju për Brigadën 113 të komanduar nga Mujë
6 Krasniqi?

7 PË. E kam njoft Mujë Krasniqin. E kam njoft. S'kam nejt me
8 ta, po e kam njoft. Kam respekt, kam pas respekt për atë djalë
9 dhe si emër kemi dëgju se na ngjitshim me emra aty, numra
10 bëjshim, bëjshim numra, biles ma vonë bojshin numra. Kam dëgju
11 për atë.

12 PY. A ke dëgjuar gjë për Brigadën 113 që e komandonte ai, siç
13 thuhet në këtë artikull?

14 PË. Kam dëgjue, kam dëgju.

15 PY. Është gjallë Mujë Krasniqi?

16 PË. Jo, nuk është gjallë Mujë Krasniqi. Ka vdek, heroikisht
17 ka vdek në kufi, si burrë.

18 PY. Ju kujtohet kur ka ndodhur kjo? Pra kur ka vdekur muajin
19 dhe vitin?

20 PË. Nuk jam me data i mirë, ju tu kërku falje, po është
21 publike kjo ajo datë që ka ndodhë. Ka qenë një tragjedi edhe
22 Muja ka vdek në atë rast.

23 PY. Do të vazhdoj të lexoj:

24 “Abedin Rexha gjithashtu formoi një grup të vet dhe e
25 shtriu në Turiqevc, Vojnik, Kllodernicë deri në Junik [Sipas

1 përkthimit], organizime që më vonë u bënë bërthama të Brigadës
2 112 të cilin e komandonte Abedini.”

3 Pyetja është kjo: Me sa dini ju, zona e përgjegjësisë së
4 Abedin Rexhës përfshinte edhe vendin që unë sapo përmenda?
5 PË. Nuk e kuptova pyetjen kështu mirë. Edhe një herë, të
6 lutem. Cilin vend?

7 PY. Po, po e përsëris. Abedin Rexha, me sa dini ju, kishte
8 përgjegjësi zonën që nga Turiqeva, Vojniku, Kllodernica deri
9 në Runik?

10 PË. Po u folke ashtu që u merrshin ato farë emrash ashtu, po
11 na ishte fillimi atëherë nuk kishim diçka që ishte, ishte
12 fillimi.

13 Z. PACE: [Përkthim] Kërkoj të nderuar Gjykatës, të
14 pranohen faqet që i tregova dëshmitarit. Në anglisht janë 0660
15 [Sipas përkthimit] deri në 66 [Sipas përkthimit] dhe faqet
16 përkatëse në shqip janë ato që mbarojnë me 6047 [Sipas
17 përkthimit].

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
19 kundërshtim?

20 Z. DIXON: [Përkthim] Po. Është një -- kemi kundërshtim.
21 Është një shembull klasik sipas mendimit tonë për nevojën e
22 një dokumenti për t'u identifikuar, sepse autori pritët të
23 vijë si dëshmitar dhe ai mund të flasë pikërisht për këtë
24 dokument që keni përpara.

25 Sigurisht dëshmia që jep dëshmitari është regjistruar në

1 procesverbal. Në qoftë se bëhet fjalë për çështje organizative
2 mund të bëhen jo duke lexuar. Por prova është aty.

3 Dhe me qëllim që dokumenti vetë të pranohet, mendoj që
4 rruga e drejtë është që të presim që të dëshmitari që
5 Prokuroria pretendon se e ka shkruar këtë dokument të vijë
6 këtu dhe të dëshmojë. Pra, mund të shënohet për t'u
7 identifikuar.

8 Z. PACE: [Përkthim] Në qoftë se, ju lutem, mund të
9 përgjigjem unë përpara se të merrni vendim.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

11 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

13 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. Në vendimin F01596,
14 Trupi Gjykses tha se dokumenti përmbush kriteret e
15 pranueshmërisë, por nuk e pranuan për mungesë të vlerës *prima*
16 *facie* pa pasur -- e vendosur në kontekst nga dëshmitari.

17 Ky dëshmitar e ka dhënë kontekstin duke konfirmuar dhe
18 shtjelluar më tej ato që thuhet. Ai është përfshirë, ka pas
19 njohuri për çështjet që trajtohen në këtë pjesë. Fakti që
20 dëshmitari i cili pretendon se ka thënë fjalët që po
21 diskutojmë është në listën e Prokurorit, nuk është një faktor
22 relevant për provueshmërinë e vet.

23 Dhe nëse nuk gabohet, Trupi Gjykses e ka hedhur poshtë
24 kundërshtimin të tillë në të kaluarën. Dhe nëse ju ndihmon për
25 vendimin tuaj, i referohem dhe vendimit F01983, paragrafët 34

1 deri në 44 [Sipas përkthimit] në lidhje me provueshmërinë e
2 dokumenteve të boturara në gazetë që i atribuohen UÇK-së apo
3 vetë të akuzuarve.

4 Nëse ka nevojë mund të paraqes parashtime të mëtejshme.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka.

6 Kemi -- keni të drejtë kemi pranuar dokumente të tilla në
7 të kaluarën dhe kundërshtimi në këtë rast ka të bëjë me peshën
8 që i japim, por jo patjetër me provueshmërinë e tij. Pra,
9 dokumenti, faqet e listuara dhe të vëna në dukje do të
10 pranohen.

11 Mund t'i jepni një numër.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në versioni në anglisht
13 IT-05-85 deri në 60 [Sipas përkthimit], faqet 7 [Sipas
14 përkthimit] dhe faqet -- versioni në shqip me numër ERN
15 SPOE00360467, do t'i jepet numri P01745. Ju lutem edhe një
16 herë Prokurorit të sqarojë klasifikimin sepse versioni në
17 anglisht është konfidencial.

18 Z. PACE: [Përkthim] Të dy mund të jenë publikë. Për të
19 qenë të qartë, faqet e vetme që duhen pranuar janë ato që
20 mbarojnë me 0467.

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po, besoj që edhe unë
22 atë lexova.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] U0467,
24 kështu?

25 Z. PACE: [Përkthim] SPOE00360467.

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dhe ta riklasifikojmë?

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po,
3 faleminderit.

4 Vazhdoni, z. Pace.

5 Z. PACE: [Përkthim] Dua që këto dokumente t'i heqim dhe
6 të paraqesim në vend të tyre dokumentin 098634-098660 përbri
7 me versionin në anglisht me të njëjtin numër ERN, por ka ET në
8 vend të AT. Faleminderit.

9 PY. Në anë e majtë, Dëshmitar, është një dokument në shqip.
10 Në të djathtë është anglisht. Këtë dokumentin në të majtë
11 përpara se t'ja u tregova javës që shkoi, e kishit parë më
12 parë?

13 PË. Jo, asnjë dokument këto që i kam pat këtu s'i kam pa ma
14 parë. Shumicën jo, por 90 për qind s'i kam pa ma parë.

15 PY. Tani, në këtë faqe midis gjithë këtyre fjalëve, dallojmë
16 Llaushë, Skënderaj, Drenicë. Aty ishit bazuar në '89 [Sipas
17 përkthimit]-'99? Aty e kishit qendrën?

18 PË. A muj të përgjigjna?

19 PY. Po, po, mund t'i përgjigjes pyetjes që të bëra.

20 PË. Është publike që Prekazi, tre-katër ditë, e Llausha një
21 muj ditë a kon qendër e vëmendjes për me i dhënë frymëzim
22 shqiptarisë në luftë me Serbinë, me uniformën Serbe. Dhe
23 vëmendja e krejt rruzullit tokësor, por edhe ndërkombëtare po
24 e shqiptarëve ka qenë në Llaushë.

25 PY. Dëshmitar, nuk më duket se po i përgjigjeni pyetjes për

1 momentin. E kishit qendrën në '98-'99 në Llaushë dhe që
2 përmendëm, Llaushë, Skënderaj dhe Drenicë dhe aty jetonit?
3 PË. Aty kam jetu dhe aty ka qenë gjithçka ato mujt e parë në
4 q'ato data ka qenë qendër Llausha e unë i kam prit delegacione
5 me qindra mrena ditës prej krejt botës edhe të shqiptarisë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
7 përpiguni të dëgjoni pyetjen dhe përgjigjuni vetëm pyetjes.
8 Mos shtoni gjëra të tjera. Nëse është e nevojshme Prokurori do
9 t'ju bëjë pyetje.

10 DËSHMITARI: Okej, po mundohena. Kërkoj falje.

11 Z. PACE: [Përkthim]

12 PY. Nuk keni nevojë të kërkonit falje. Sa për të qenë të
13 qartë. Ju vetë keni marrë pjesë në luftime në Llaushë në '98?

14 PË. Po non-stop, na kemi qenë baza aty. Unë kam qenë një
15 përgjegjës i shtetit të Kosovës, i kushtetutës së Kaçanikut.
16 Në nivel të shtetit të Kosovës, unë kam qenë ai përgjegjësi
17 për Drenicë që tana proceset e mëdhaja kanë kalu asajde kah
18 unë. Jam personazh që i kam bart përgjegjësinë për të gjitha
19 edhe sot para juve e mbaj përgjegjësinë për të gjitha ato që
20 kam bo. Kam dëshirë edhe të tjerët me e marrë përgjegjësinë që
21 kanë bo.

22 PY. Edhe një herë, Dëshmitar, ju lutem përgjigjuni më shkurt
23 pyetjeve që të ecim përpara. E kuptoni?

24 PË. Po.

25 PY. Faleminderit.

1 Z. PACE: [Përkthim] Të kalojmë në faqen 08649 në të dy
2 versionet -- 098642.

3 PY. Dëshmitar, siç mund ta shini, në këtë faqe që keni
4 përpara në të majtë në shqip dhe në të djathtë në anglisht,
5 kanë datën, mbajnë datën 3, 4, 5 qershor. Secili nga shënimet
6 në faqe i referohet luftimeve, të shtënave, bombardimeve të
7 ndodhura në atë ditë. Ju kujtohet se ka ndodhur kjo në qershor
8 '98-s, konkretisht në Llaushë?

9 PË. Po, më kujtohet, edhe këto janë të vërteta. Gjithë këto
10 janë të vërteta.

11 PY. Në shqip po kalojmë në qoshen e fundit, aty përmenden
12 luftimet në Llaushë dhe një firmë "komandanti i zonës
13 luftarake". E njeh këtë nënshkrimin?

14 PË. Shumë interesat është. është një nënshkrim duket si me
15 kon, po nuk është nënshkrimi im se unë e kam, unë kam dhënë
16 informata me telefon në Qendrën për Informim të Kosovës te
17 Enver Maloku, që e ka përcjellë brenda ditës në tanë
18 përfaqësitë ku i kem pas në krejt botën dhe ky shkrim
19 sigurisht është i dikujt që unë nuk po e di kush o, po fjalët
20 janë të mijat. Se unë kam thonë në telefon kam fol, veç në
21 telefon, atje janë përcjellë.

22 PY. Siç thatë, këtu thotë "komandanti i zonës luftarake të
23 Llaushë", ju thoni në atë kohë ishit ju komandant apo ka qenë
24 dikush tjetër me sa dini?

25 PË. Edhe një herë me e zgat, po më the mos e zgat, pa sqaru

1 s'bohet. Unë kam qenë përgjegjës i shtetit të Kosovës i
2 zgjedhjeve, i Ministrisë së Mbrojtjes, kam qenë një prej
3 përgjegjësve, jo komandant ose të mëdhej, [E pakuptueshme] po
4 kam qenë përgjegjës. Unë kam marrë përgjegjësinë për këtë
5 lëmi. Këtu nuk po i shoh unë me emra goxha fort si nënshkrim,
6 F. Geci, po s'o i jemi. Ka mujt me e shkru dikush pa kon une.
7 S'a nënshkrimi jem.

8 Z. PACE: [Përkthim] Të kalojmë tek faqja tjetër, 098644
9 [Sipas përkthimit]. Të shikojmë dy versionet në shqip dhe në
10 anglisht.

11 PY. Dëshmitar, kjo është një tjetër faqet e dokumentit për të
12 cilin po diskutonim dhe më herët. Shikojmë që data në fillim
13 fare është 7 qershor dhe këtu flitet për ushtrinë ose forcat
14 ushtarake serbe që granatojnë lagjen e Gecajve. Në këtë
15 periudhë, domethënë, në qershor 1998, a keni jetuar në lagjen
16 e Gecajve ju, Dëshmitar?

17 PË. Po.

18 PY. A ju kujtohen grantimet atje, a ka pasur granatime në
19 javën e parë të qershorit 1998 sikurse shkruhet këtu?

20 PË. Të përditshme, të përditshme.

21 Z. PACE: [Përkthim] Të kalojmë në faqen 098655 në të dyja
22 versionet.

23 PY. Dëshmitar, shënimet në këtë faqe mbajnë datën 19, 20 dhe
24 21 korrik 1998 dhe përsëri kemi bëjmë me Llaushën. Në secilën
25 prej këtyre shënimeve flitet për shkëmbime zjarri ose të

1 shtëna sporadike. A ju kujtohet të ketë ndodhur kjo në Llaushë
2 në këtë periudhë kohe nga data 19, 20, 21 korrik 1998?

3 PË. Më kujtohet se isha asajde përgjegjës i asajde isha. Dhe
4 është në kokën teme ajo, si muzikë për çdo ditë na e kemi pasë
5 gjuajtje breshëri sikur na muzikë me kon. Ato na u ka pas bo
6 muzikë.

7 PY. Në atë kohë, në korrik 1998, a ju kujtohet të keni dhënë
8 informacion të ngjashëm me informacionin që keni këtu në faqen
9 përpara? I keni dhënë këtë lloj informacioni ndokujt,
10 pavarësisht arsyes se pse?

11 PË. Një herë une kam qenë një përfaqësues që ka pas adresë
12 Drenica, një person që a kon i zgjedhur me votë dhe çdo gjë
13 janë drejtu aty te unë. Unë i kam prit. Dhe kam dhënë krejt
14 ç'ka kam dit dhe ça ka mujt në atë kohë e kam dhënë, edhe me
15 siguri po edhe këto janë ato që i kam dhon.

16 PY. A ju kujtohet në qoftë se ka pasur persona të tjerë që
17 mund të kenë dhënë të njëjtën informacion si ky informacioni
18 që kemi përpara në atë kohë, domethënë në korrik '98?

19 PË. Une në bazë të qëtyre shënimeve që i pashë këto janë,
20 janë informatat që i kam dhënë une në Qendrën Informative të
21 Kosovës të përditshme, i kam pas në një ditar të regjistrum,
22 po mu ka djegë. I kam pas të gjitha shënimet, po mu ka djegë,
23 s'e kam, fatkeqësisht s'e kam.

24 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në këtë rast
25 kërkohet që të pranojmë si provë gjyqësore i gjithë dokumenti.

1 pra, nga faqja 098634 deri në 098660 së bashku me përkthimin
2 anglisht.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
4 kundërshtim?

5 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne
6 kundërshtojmë për të njëjtat arsye. Shtojmë gjithashtu që
7 pesha që i jepet një dokumenti të tillë të ngjashëm, një
8 dokument për të cilën dëshmitari - nuk flas si dokument, ai
9 mund të flasë lidhur me faktin, për shembull, kemi dëshmi që
10 kanë të bëjnë me sulmet serbe, datat kur kanë ndodhura këto,
11 megjithatë kjo ka bërë thjeshtë me dëshminë e tij. Kështu që
12 sa i takon peshës ky dokument nuk është se ka ndonjë peshë
13 parë nga këndvështrimi i dëshmisë së dëshmitarit. Pra, ndoshta
14 po të kishte mbajtur ndonjë shënim vetë dëshmitari, ky mund të
15 kishte pasur peshë, po nuk e dimë se çfarë vlere mund të ketë,
16 çfarë peshe mund të ketë ky dokument.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dhe ne i
18 bashkohemi këtij kundërshtimi. Në qoftë se do pranohet ndonjë
19 dokument, duhet që të pranohen vetëm ato faqe që iu treguan
20 dokumentit, jo -- vetëm faqet që iu treguan dëshmitarit, jo i
21 gjithë dokumenti.

22 Z. PACE: [Përkthim] A mund t'i përgjigjem?

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

24 Z. PACE: [Përkthim] Dëshmitari konfirmoi që ai në të
25 gjithë periudhën që përmendet në dokument ka qenë i

1 stacionuar, pra në vitin 1999 dhe 1998 në atë zonë dhe ka
2 marrë pjesë në sulmet vetë. Pra, ka marrë pjesë në sulmet e
3 qershorit dhe korrikut 1998. Ai tha se ka dijeni lidhur me
4 sulmet.

5 Dhe sa i takon kundërshtime të thëna nga z. Dixon ne po
6 flasim -- nuk po flasim për peshën tani, thjeshtë po flasim
7 për pranueshminë. Dhe ju, të nderuar anëtarët e Trupit Gjykues
8 keni vendosur në parashtrimin F02644, në paragrafin 11 sa i
9 takon pranueshmërisë së dokumenteve që autori mund të mos
10 dihet, megjithatë pranueshmëria nuk ka të bëjë domosdoshmëri
11 me autorësinë e dokumentit.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyetja ime ka
13 të bëjë dokumentet me faqet e tjera, jo vetëm me faqet që iu
14 bënë, për të cilat iu bënë pyetje dëshmitarit.

15 Z. PACE: [Përkthim] Sikurse e thashë, faqet e tjera
16 përmendin informacion të ngjashëm me informacionin të cilin ne
17 e trajtuam me dëshmitarin.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Dëshiroj që të ngre diçka për
19 procesverbal pa praninë e dëshmitarit në qoftë se më lejoni.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
21 le ta nxjerrim dëshmitarin nga salla.

22 DËSHMITARI: Mos bre! Mos [E padëgjueshme].

23 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

24 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Dëshirojmë që të bëjmë një
2 parashtrim lidhur me relevancën dhe me vlerën provuese. Mesa
3 kuptova unë dëshmitari tha që nuk ka qenë pjesë e zinxhirit
4 komandues të Shtabit të Përgjithshëm, por ka qenë pjesë e
5 Ministrisë së Mbrojtjes. Kështu që neve kundërshtojmë pranimin
6 sa i takon relevancës dhe vlerës provuese. Nuk e dimë se çfarë
7 vlere provuese dhe çfarë relevance ka ky dokument, për aq kohë
8 që ai ka atë pozicion që unë përmenda pak më herët.

9 Z. PACE: [Përkthim] A mund t'i përgjigjem?

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

11 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, lidhur me atë
12 çfarë tha dëshmitari dhe luftimeve ku ka marrë pjesë, ai nuk
13 ka dhënë gjë lidhur me relevancën për këtë dokument, por
14 ndërkohë ka dëshmuar sa i takon konfliktit të armatosur jo-
15 ndërkombëtar dhe UÇK-së. Kemi gjithashtu dhe informacion që ka
16 të bëjë me dijeninë e këtij dëshmitari që është pranuar sipas
17 deklaratës sipas rregullës 154. Ky informacion jepet
18 gjithashtu edhe në shënimin përgatitor lidhur me luftimet e
19 forcave të UÇK-së dhe luftëtarëve të Ministrisë së Mbrojtjes.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

21 Nuk kam dyshim sa i takon relevancës së këtij materiali sepse
22 konflikti -- për shkak të konfliktit të armatosur megjithatë
23 nuk shikojmë ndonjë arsye për të prezantuar faqe të tjera dhe
24 për të kërkuar që faqet e tjera të mund të kërkohen si prova.
25 Kështu ne do të pranojmë faqet për të cilat iu bënë pyetje

Dëshmitari: Fadil Geci (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 37

1 dëshmitarit.

2 A mund të na i thoni edhe një herë faqet?

3 Z. PACE: [Përkthim] Po. faqet e përmendura janë: 098634,
4 098642, 098643 dhe 098655.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faqet që u
6 përmendën pranohen si prova gjyqësore.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të
8 nderuar Gjykatës. Faqet e përmendura, versionet në shqip dhe
9 në anglisht do të marrin numrin e provës P01746. Aktualisht
10 klasifikimi është konfidencial.

11 Z. PACE: [Përkthim] Mund të riklasifikohet si publik.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
13 riklasifikoheni.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë, mund të
16 vazhdojmë, zoti [E padëgjueshme].

17 [Dëshmitari vijon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

19 Tani mund të vazhdojmë më tej, z. Dëshmitar.

20 Z. Prokuror, mund të vazhdoni.

21 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

22 Do i lutesha Sekretares ta heqë këtë dokument nga ekрани
23 dhe në vend të tij të vërë dokumentin 098249 deri në 098291 --
24 991 përbri dokumentit 094249-098291-ET. Dua që konkretisht që
25 paraqitet në ekran faqja 098264.

1 PY. Dëshmitar, do t'ju pyes së pari, a e ke parë më përpara
2 këtë dokument sesa t'ja u tregoja unë javën më përpara?

3 PË. Jo, nuk e kam pa asnjë këto dokument. Për herë të parë
4 jam për mu.

5 PY. Do të lexoj versionin në anglisht, më ndiqni përmes
6 përkthimit.

7 "Problemet me të cilat u përball, u ballafaqua Këshilli i
8 Emergjencës u diskutuan në një takim më 5 qershor 1998. Në
9 mbledhje u zgjodhën Këshilli i ri i Emergjencës dhe u vendos
10 që të kishte të njëjtën përbërje si më përpara. Personat që u
11 përfshinë në këtë këshill ishte Nezir Geci, unë, Shaban
12 Zyrhani, Haxhi Geci, Ramiz Haziri, Haxhi Qerimi. Dhe situata
13 dhe mbledhja e ndihmës ishte ndër çështjet të cilat ne i
14 diskutuam. Po ashtu u diskutua për situatën alarmuese.

15 "Ne diskutuam situatën shumë të rëndë në të cilën ishim
16 dhe rrugën përpara."

17 Atëherë, ky është një shënim që ka të bëjë me një këshill
18 emergjence. A e keni dëgjuar ndonjëherë ekzistencën e këtij
19 këshilli në '98 ose '99, domethënë, Këshillin e Emergjencës,
20 Dëshmitar?

21 PË. Unë këtë dokument po e shof për herë të parë. E gjithë
22 ato të tjerat kanë kalu ka une, ka shtëpia jem, në shpi teme a
23 kon emergjenca, në familjen teme.

24 PY. Ju lutem, përgjigjuni pyetjes. A jeni në dijeni të faktit
25 që ka pas një këshill emergjence në '98 apo '99, Dëshmitar?

1 PË. Po ka pas se kemi pas gjendjen e jashtëzakonshme. Ne e
2 kemi formu, unë e kam formue me kryesinë, atëhere LDK-ja lujke
3 rolin e shtetit. Na jemi kon i parti, po s'jemi kon veç parti.
4 Se kemi bo edhe zgjedhje, kemi majt edhe referendum, kemi kry
5 edhe punë të tjera. I kemi kry punët e shtetit në atë formë
6 brenda okupimit.

7 PY. Sapo thatë që çdo gjë ka shku përmes familjes tënde,
8 shtëpisë tënde. A mund t'i thoni Trupit Gjykues se ku ka qenë
9 stacionuar, ku e ka pas qendrën ky këshill, Këshilli i
10 Emergjencës që përmendet te ky shënimi, Dëshmitar?

11 PË. Këshilli i Emergjencës e ka pas qendrën në shtëpi teme.

12 PY. Tek ky shënimi, përmendet një takim në '98, më 5 qershor
13 dhe që Këshilli i Emergjencave të mund të vendoste që të
14 vazhdonte që të qëndronte në të njëjtën, në të njëjtin vend. A
15 mund të na thoni, Dëshmitar, se pse ishte e nevojshme që të
16 kishte një vendim ku përcaktohej që Këshilli i Emergjencës do
17 të vazhdonte ta kishte qendrën te shtëpia juaj?

18 PË. Po çdo gjë veç fillon një luhajtje, ashtu që tash po
19 dihet, dy drejtime, dy organizime. Deri atëhere ne nuk kishim
20 dëgjju, veç një organizim e kishim edhe ishim tanë bashkë.

21 PY. A mund t'ja u sqaroni Gjykatësve se për çfarë e ke fjalën
22 këto dy organizime? Cilët ishin këto dy organizimet, na e
23 sqaroni pak?

24 PË. Jua sqaroj veç mos të bëj tepër, mos ta zgjas. Organizimi
25 shtetnor, mbrojtja e kushtetutës, lufta brenda sistemit tonë

1 asi çfarë e kishim, ka qenë një drejtim që kemi qenë tanë
2 unikë, të gjithë, pa astenjë. 99 për qind të popullit të
3 Kosovës kemi qenë në një vend.

4 Edhe dikur në momentin mas Jasharëve ka ardhë një grup
5 prej jashti që e përfaqësojnë këtu disa që janë këtu, e disa
6 janë kon mrena dhe na kanë përça popullatën në përgjithësi, se
7 në Kosovë kanë qenë dy grupe njeri për shtet e tjetri për
8 pushtet. Grupi që ka qenë për shtat jam unë, në krye me
9 Presidentin Ibrahim Rugova, ku e mbaj përgjegjësinë për
10 Drenicën; kurse grupi që ka qenë për pushtet janë disa këtu që
11 po i shoh dhe do të na spjegojnë pse, qysh, si, ç'ka, e unë
12 jam këtu me u ballafaqu me ta.

13 PY. Si e ka emrin ky grupi tjetër që përmendi ju?

14 PË. Grupi i LPK-së, i OVLK-së, i organizatës marksiste-
15 leniniste që e ka pas kryet në Rusi. Edhe grupi tjetër, është
16 grupi i LDK-së që e ka pas kryesinë në Amerikë. Grupi i parë e
17 ka qujt Amerikën armik, kurse ne kemi thanë se vetëm Zoti e
18 Amerika, anglo-amerikanët bashkë me popujt demokratë evropianë
19 mujn me na arrit me u çliru. Unë e kam mbrojt këtë drejtim.

20 PY. Dëshmitar, e di që keni shumë për të thënë, megjithatë do
21 ju kërkoja që në qoftë se ju bëj një pyetje duhet që t'i
22 përgjigjeni pyetjes që të bëj. Për shembull, në qoftë se të
23 them që cili ka qenë emri i organizatës, thjesht thoni emrin.
24 Do i kthehem përsëri pyetjes që ju bëra pak më herët. A keni
25 ndonjë ide se pse, sikurse thuhet te kjo pjesa duhej që të

1 kishte një vendim që qendra e këshillit të vazhdonte të ishte
2 në shtëpinë tuaj? E dini arsyen se pse ishte e nevojshme kjo?

3 PË. Ndikimi jonë ishte i madh në atë pjesë, në atë zonë, në
4 atë rreth dhe disa nuk e dojshin me kon ai ndikim, kanë bo
5 përpjekje me largu pej neve pak, me dalë pak me hjek pej
6 shpisë, pej njerëzve. Kjo është ajo qëllimi.

7 PY. Kush ka bërë përpjekje që ta hiqte Këshillin e
8 Emergjencës nga shtëpia jote, Dëshmitar?

9 PË. Përpjekje që ta heqi emergjencën nga shtëpia janë
10 njerëzit që kanë ardhë të LPK-së, e ma vonë të konventum që
11 jemi kreu i UÇK-së, pa pas asnjë anëtar, veç kreun ma ja
12 nxanë, janë qëta që thashë.

13 PY. A keni njohuri lidhur me ndonjë rast konkret ku dikush
14 nga LPK-ja ka pohuar ose ka thënë që qendra duhej që të
15 ndryshonte, domethënë, qendra e këshillit të emergjencave
16 duhet të ishte diku tjetër?

17 PË. Kjo -- [E padëgjueshme] veç bisedë që u bo, veç bisedë që
18 u luhat ajo dihet kah ka ardhë ajo frymë. Këto e pamë ma vonë
19 me Komunikatën 59. Mbas familjes Jashari tentun me na likujdu
20 familjen tonë, vëllaun tonë dhe me e hjek ndikimit në atë
21 terren me rrena, me shpifje, që o turp që mendoj që ata njerëz
22 që e kanë shkru Komunikatën 59, duhet me ja u bo ADN-në se mun
23 me kon çargashë e jo shqiptarë.

24 PY. Dëshmitar, pyetja ime është kjo: A ju kujtohet ndonjë
25 rast konkret - më dëgjoni, Dëshmitar. A ju kujtohet ndonjë

1 rast konkret ku ndokush nga LPK-ja ka deklaruar apo ka pohuar
2 që magazina e Këshillit të Emergjencave duhet të lëvizet, pra
3 nuk duhet të vazhdojë të qëndrojë më aty ku ishte në shtëpinë
4 tuaj?

5 PË. Unë edhe një herë, ishin do që prej Prishtine mbajshin
6 konferenca, hala pa kyçun. Na ishim në luftë, ata prej
7 Prishtine na mësojshin. Disa përfaqësues të OMLK-së,
8 organizatës marksiste-leniniste. Edhe përpjekjet e tyre ishin
9 me i hjek ndikimin prej këtuhit, prej Llaushe edhe me e çu te
10 njerëzit e vet që menoishin që i kanë të vet, që do të thotë
11 shumë, dhe aty kanë fillu përçarja në Kosovë mes këtyne
12 njerëzve.

13 Dhe grupi tjetër që jam unë, kemi rujt gjithçka çka është
14 në interes, vetëm përçarje nuk ka guxu me kon. Kjo është
15 këshilla e Presidentit Ibrahim Rugova. Një mijë vetë mujn me u
16 vra në njënën anë, një mijë njeri nuk guxon në tjetër grup me
17 u vra se atë e do Serbia. E disa njerëz njerëz dikur do të
18 turpnohen edhe fëmija e tyre kanë me u trupnu, na duhet me pas
19 kujdes, duhet me u ru edhe kjo është këshilla ju kemi
20 përmbajtë me përpikni dhe ka pas bereqet edhe nihu mirë.

21 PY. Dëshmitar, ja u përmenda disa herë, por po ju them edhe
22 një herë, ju lutem, më dëgjoni çfarë po u them. Dëgjoni
23 pyetjen që po ju bëj dhe jepini përgjigje. Ju lutem, jepini
24 përgjigje pyetjeve të mia dhe mos e shtjelloni më tej. E
25 kupton këtë që sapo të thashë, apo jo? Në qoftë se ka nevojë

1 për shpjegime të tjera, do ju thotë Trupi Gjykses pastaj.

2 PË. Kërkoj falje. Ka i her po më thue sqaroj, unë s'kam qare
3 pa e sqaru. Kërkoj falje para Gjykatës. Nëse më lejoni me
4 sqaru duhet me i sqaru.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës,
6 kërkoj ndjesë që ndërpres kolegun. Megjithatë, ajo çfarë vërej
7 është që përkthimi ndonjëherë vazhdon përpara sesa -- ndërkohë
8 që fillon me pyetjet Prokurori. Kështu që më thonë që e kemi -
9 - na ka munguar pjesa e përkthimit në anglisht që thotë që:

10 "Sipas Komunikatës -- ata që kanë shkruar Komunikatën 59,
11 ata duhet -- atyre duhet t'ju bëhet analiza e gjakut, dhe ata
12 nuk duhet të jenë shqiptarë."

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

14 Ju lutem, thoni -- bëni një pauzë në mënyrë të tillë që
15 të reflektohet çdo gjë në procesverbal.

16 Z. PACE: [Përkthim]

17 PY. Dëshmitar, në përgjigjen që sapo e dhatë lidhur me
18 njerëzit nga Prishtina, që ka të bëjë me kërkesën ose
19 sugjerimin që të zhvendosej ose të vendosej në një vend tjetër
20 këshillimi i emergjencës. Po ju bëj një pyetje që ja u bëra
21 disa herë më përpara. A ju kujtohet apo jeni në dijeni të
22 ndonjë personi që ka sugjeruar apo ka dashur që qendra e
23 këshillit të emergjencave të largohet, të zhvendoset nga
24 shtëpia jua të shkojë diku tjetër? Po apo jo?

25 PË. Po. Unë vetëm një -- nëse më lejohet, janë disa

Dëshmitari: Fadil Geci (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 44

1 konferenca, thashë ma parë, që janë mbajt në nivel të
2 Prishtinës prej përfaqësuesve të OML-së.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
4 ndalo këtu. Ju lutem, dëgjoni pyetjen dhe jepini përgjigje
5 vetëm pyetjes që ju bëhet.

6 Z. PACE: [Përkthim]

7 PY. Nëse e dini kush janë personat ose personi që kanë
8 deklaruar që është e nevojshme që të largohet, të ndryshohet
9 vendi i këshillit të emergjencave, pra të mos ishte më në
10 shtëpinë tuaj? Kush e ka thënë këtë gjë?

11 PË. Këtë e ka thënë Gani Koci, që është përfaqësues i tyre në
12 nivel të Prishtinës.

13 PY. A ju kujtohet në qoftë se Jakup Krasniqi ka bërë ndonjë
14 pohim të tillë në publik? E ka ndonjë gjë të ngjashme z.
15 Krasniqi?

16 Z. ELLIS: [Përkthim] Është pyetje orientuese.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.
18 Mund të vazhdoni.

19 Z. PACE: [Përkthim] Ishte pyetje e hapur.

20 DËSHMITARI: Jakup Krasniqi për çdo ditë na ka thirr në
21 Llaushë prej Prishtine thojke "Zoti ju ndihmoftë. Zoti ju
22 ndihmoftë. Zoti ju ndihmoftë". E na ishim në luftë. E ai dikur
23 erdh e me grusht u bo kryesori [E pakuptueshme] që kjo është e
24 vërteta, prej Prishtine na ka [E pakuptueshme].

25 Në telefon, a kon një telefon atje kund telefon me

1 rrjetë, për çdo ditë kur ka mujt tash, a për çdo ditë është
2 shumë, po thojke "Zoti ju ndimoftë". Boll është edhe ajo fjalë
3 e mirë. Na ka ndihmu Zoti.

4 Z. PACE: [Përkthim]

5 PY. Dëshmitar, dokumenti flet për anëtarët e këshillit të
6 emergjencave, përfshirë këtu disa persona që ishin Nezir Geci,
7 Shaban Zyrhani, Haxhi Geci, Ramiz Haziri dhe Haxhi Qerimi. A e
8 dini ju në qoftë se këta persona vërtetë kanë qenë anëtarë të
9 këshillit të emergjenca, Dëshmitar?

10 PË. Po. Të gjithë kanë qenë persona, djemtë ma të mirë të
11 fshatit që e kanë kry detyrën me nder edhe në luftë edhe në
12 emergjencë. Disa kanë pas pasoja masaj janë nxon rob e kanë
13 pas telashe. E kam vëlla Haxhi Gecin ka qenë edhe kryetar i
14 nëndegës atje edhe në emergjencë, vëllai im është Haxhi Geci.

15 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë që kjo
16 faqe të pranohet si provë gjyqësore.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
18 kundërshtim?

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

20 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kundërshtoj për
21 të njëjtat arsye që i përmenda më herët. Nuk dua ta përsëris
22 edhe një herë atë çfarë thashë, por dëshiroj të them
23 gjithashtu që dëshmia e dhënë nga ky dëshmitar, mund të bëhej
24 përmes pyetjeve të hapura. Për shembull, nuk ishte e nevojshme
25 fare që të përmendej dokumenti dhe thjeshtë të bëheshin pyetje

1 atij lidhur me këshillin e emergjencave. Në parashtrimin tonë
2 kjo është mënyra se si duhej të ishte vepruar.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne
4 kundërshtojmë këtë dokument sepse mendojmë që nuk është
5 relevant.

6 Z. PACE: [Përkthim] Sa i takon sugjerimit për
7 racionalitetin, unë e di që dëshmitari e ka përmendur
8 këshillimin e emergjencave në deklaratat e tij të cilat tani
9 janë pranuar sipas rregullës 154.

10 Sa i takon relevancës, padyshim që dëshmitari po flet
11 lidhur me institucionin e LDK-së dhe ka edhe informacion që
12 dha dëshmitari sa i takon heqjes së këtij institucioni dhe e
13 dha gjithashtu -- e tha në deklaratën e vet dëshmitari që
14 është në dijeni të personave që kanë bërë deklarata të tjera
15 për ta zhvendosur qendrën e këshillit të emergjencave. Po
16 ashtu edhe dëshmi lidhur me marrëdhënie ndërmjet LDK-së dhe
17 UÇK-së.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është
19 dokument relevant dhe do të pranohet si provë gjyqësore.
20 Dokumenti 0 -- ju kërkohet ndjesë, faqja 098264 plus versioni në
21 anglisht, përkthimi në anglisht do të pranohet si prova
22 gjyqësore.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
24 faqja sapo u përmend në anglisht dhe në shqip do të pranohen
25 si prova me numrin P01747. Aktualisht dokumenti klasifikohet

1 si konfidencial.

2 Z. PACE: [Përkthim] Mund të riklasifikohet si publik.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
4 riklasifikoheni.

5 Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem, hiqeni dokumentin,
6 Sekretare.

7 PY. Ju përmendët Gani Kocën. A ju kujtohet nëse Gani Koca ju
8 ka vizituar ju tek shtëpia në Llaushë apo ka qëndruar
9 ndonjëherë me familjen tënde? Të kujtohet kjo?

10 PË. Po.

11 PY. Kur ka ndodhur kjo, Dëshmitar?

12 PË. Pas konferencave për shtyp në nivel të Prishtinës. Ne e
13 kemi si dajë të babës Gani Kocën. Dhe Ganiu vëllaun me Besim
14 Dajakun e kanë taku në Likovc edhe i kanë thonë "ec me ne me i
15 këqyr a është Llausha në rrezik a jo. Dhe që po flet
16 përçarjes. Ke me nejt sonte me ne".

17 PY. Për të qenë të qartë, kush ka thënë "Ke me nejt sonte me
18 ne"? Kush e ka thënë kujt ja ka thënë?

19 PË. Besim Dajaku i ka thënë Gani Kocës edhe Gani Gecit,
20 vëllaun.

21 PY. Kur ka ndodhur kjo, në cilin muaj apo vit? Kur ka ardhur
22 Gani Koca për t'ju vizituar tek shtëpia juaj?

23 PË. këto janë mas, mas '98 qëto emergjencat e qëto
24 përshtjellimet, q'ato që u folke me marrë ndikimin LPK-ja.

25 Këto janë krejt këto përshtjellimet të LPK-së që tentojshin me

1 fy Llaushën, me i nda Llaushën prej atyne proceseve në interes
2 edhe me vazhdu me të tyne.

3 PY. A e kuptova drejtë që kjo ka ndodhur pas 1998, domethënë
4 i takon që ka qenë në 1999 apo jo, Dëshmitar, na e sqaro pak.
5 PË. Të lutem, në 1998, mars, prill, mars qershor 1998. Hala
6 nuk ishin të inkuadrum këta, disa LPK ishin në nivel të
7 Prishtinës. Bëjshin përpjekje mrena LDK-së me i merr kokën e
8 LDK-së. Pa asnjë anëtar veç kokën. Qysh e morën në UÇK, veç
9 kokën.

10 PY. Për të na orientuar pak më mirë lidhur me kohën. Kur ka
11 ndodhur kjo, domethënë, kur Gani Koca ka ardhë për të qëndruar
12 në familjen tënde, kjo ka ndodhur pasi është publikuar
13 Komunikata 59, apo përpara sesa të publikohej?

14 PË. Përpara se këto kanë fillu pak më herët. Para se me
15 fillu, përpara Komunikatës 59. Domethënë, mars, prill, maj,
16 qershor, këta muaj janë kon. Lufta e kësaj përçarjeje që
17 shqiptarisë a kon këta muaj. Ma herët s'kemi pas jemi kon
18 shumë unik, komplet, 99.9 për qind jena kon unikë të gjithë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace, ka
20 ardhur koha për pushimin.

21 Z. PACE: [Përkthim] Në rregull. Mund të bëjmë pushimin.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
23 bëjmë pushim për 30 minuta tani. Do kthehemi përsëri në orën
24 3.00.

25 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

1 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ndërkohë që kemi
2 këtu besoj që do më duhet që të kërkoj pak më tepër kohë sepse
3 e di që kam kërkuar dy orë, por të paktën më duhet edhe 30
4 minuta. Mbase edhe pak më tepër po gjithsesi do ju kërkoj kur
5 të vijë momenti i përshtatshëm për më shumë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
7 Do bëjmë pushim deri në orën 3.00.

8 --- Pauza fillon në orën 14.30

9 --- Seanca fillon në orën 15.00

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sipas
11 kërkesës tuaj, z. Pace, do ta marrim vendimin më vonë. Të
12 shikojmë.

13 Silleni dëshmitarin në sallë.

14 [Dëshmitari vijon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Geci, do
16 të vazhdojmë me pyetjet që do të vazhdojë t'ju bëjë
17 Prokuroria.

18 Vazhdoni, z. Pace.

19 Z. PACE: [Përkthim]

20 PY. Dëshmitar, përpara pushimit na thatë që Gani Koci kishte
21 ardhur apo qëndruar në shtëpinë tuaj përpara se të botohej
22 Komunikata 59. Ju kujtohet nëse erdhi ndonjë nga pjesëtarët e
23 UÇK-së gjatë kohës që ai ishte në shtëpinë tuaj?

24 PË. Po, më kujtohet mirë, si sot.

25 PY. Kush edhe për ta vizituar?

1 PË. Të gjithë. Rexhep Selimi, Hashim Thaçi, i biri i Haxhisë
2 prej Buroje, prej Haxhi Polarit edhe tjerë. Edhe tjerë që
3 s'janë diçka emna.

4 PY. Ju ishit vetë aty i pranishëm kur Rexhep Selimi e vizitoi
5 Gani Kocën kur qe në shtëpinë tuaj?

6 PË. Jo, Ganiu, vëllau ka qenë i pranishëm. Unë kam qenë i
7 pranishëm kur ka ardhë Hashim Thaçi.

8 PY. Nuk më duket se e kuptova përgjigjen mirë. Pyetja ishte:
9 Ju vetë ishit i pranishëm kur Rexhep Selimi erdhi në shtëpinë
10 tuaj?

11 PË. Jo, nuk kam qenë unë vetë. Nuk më kujtohet që kam qenë.
12 Mu më kujtohet vetëm kur ka ardhë Hashim Thaçi që unë kam fol
13 me të dhe drejtpërdrejt.

14 PY. Nga e dini ju që Rexhep Selimi erdhi në shtëpinë tuaj?

15 PË. Po na kena bisedue me vëllazën. Kemi bisedue. Ganiu më ka
16 tregue që ka qenë Rexhepi. Me kërrkën ka qenë, unë tash -- po
17 ka qenë.

18 PY. Ganiu vëllai ju tha ndonjë gjë tjetër lidhur me vizitën e
19 Rexhep Selimi në shtëpinë tuaj?

20 PË. Nuk e kam pyet në detale, por një më ka thënë që e kam.

21 PY. Çfarë ju tha?

22 PË. I ka thënë që "Unë", ky Rexhepi i ka thënë "Unë jam
23 Rexhep Selimi", diçka jam mendjemadh. Kurse Ganiu i ka thënë
24 "Unë jam Gani Geci edhe hajde çahu prej këtu".

25 PY. Ti kthehemi faktit që Hashim Thaçi erdhi në shtëpinë tuaj

1 dhe ti ishe i pranishëm. Çfarë tha, nëse ju tha gjë Hashim

2 Thaçi gjatë vizitës së tij?

3 PË. Po, më kujtohet mirë.

4 PY. Çfarë ju tha Hashim Thaçi juve apo në praninë tuaj, nëse

5 tha gjë gjatë kësaj vizite?

6 PË. Kur jam hy unë ish kanë tuj ju thënë që "Nuk jem në

7 parti, s'jam kanë në parti". Unë i thashë "Ti je kanë një javë

8 ditë kryetar i referendumit, kryetar i Forumit Rinor të LDK-së

9 në Skënderaj". Tha "Kam rrejt". I thashë "Ke rrejt. Ti je

10 rrens atëhere dhe sot. Çka të flet ti rren edhe shpif". Më ka

11 marrë për dore, nëse se bëj tepër muj edhe shkoj pi shkurt

12 edhe më ka qit përjashta mbas asaj fjale. Dhe unë nuk e

13 kuptojsha çfarë, s'mujsha me kuptu. S'po e çoj më tej, atje e

14 kam thënë, më andej s'po e çoj. E keni në material. Nuk besoj

15 që ka nevojë ma shumë me fol. Nëse ka them edhe atë.

16 PY. Dëshmitar, mbase është mirë të na sqarosh. Përmend një

17 incident që Hashim Thaçi të ka puthur dorën. Për këtë po thua

18 tani?

19 PË. Po, kjo është e vërtetë, që unë nuk kisha në atë fenomen

20 që dy burra puth dorën, po nuk deshta me ia thënë këtë. Këtu

21 s'doshta që tash, po që po e them që ashtu ka qenë. E kam

22 thënë edhe disa herë, kjo është e vërtetë, këtu jem bashkë me

23 të. Le të më thotë që s'është q'ashtu.

24 PY. Dëshmitar, the që Hashim Thaçi --

25 PË. Po.

1 PY. -- po bisedonte me dikë kur ti hyre. Me kë po bisedonte?

2 PË. Po me atë stafin aty që si dikush kush ka qenë brenda nuk
3 janë -- nuk, s'janë diçka kështu kush ka qenë aty dikush deri
4 jam hy unë. Dikush ka qenë aty tonë dikush po unë nuk po --
5 s'po më kujtohet. Unë po më kujtohet dueli im drejtpërdrejt me
6 të. Prandaj aty e kam pa, e nderuara Gjykatë, ju të pranishëm
7 e të gjithë ata që na përcjellin, se një person që bën atë
8 gjest është i rrezikshëm edhe për shqiptari edhe për shokë të
9 vet që kanë me pa më vonë kush a. E unë atëherë s'i kam kuptu.

10 Z. PACE: [Përkthim] Dua që të paraqesim në ekran
11 materialin U002-3545-U002-3558 përbri me versionin në anglisht
12 dhe dua që të kalojmë në faqen 2, U002-3550, ju lutem.

13 PY. Dëshmitar, këtë faqen në anën e majtë e ke parë përpara
14 se ta tregoja unë javës që shkoi?

15 PË. Edhe një herë, jo shumë, po 95, materialet, për qind unë
16 nuk i kam pa këto hiç. S'jam marrë shumë me to. S'kam dit hiç.
17 Kishin pas shkru për mu boll, po kishin pas shkru mirë
18 faleminderit, se q'ashtu u kanë. Shumica janë q'ashtu ça kam
19 thënë është e vërtetë. Është në interes të nderit të
20 përgjithshëm të Kosovës dhe shqiptarisë, që kam qenë
21 përfaqësues i shtetit.

22 PY. Do lexoj nga ajo paragrafi që fillon:

23 "Në 25 prill shkova të takoj Abedin Rexha dhe i propozova
24 të caktonte Kadri Halitin si personi përgjegjës për
25 Kastriotin. Mbasi u konsultua me shokë të tjerë, ai e hodhi

1 poshtë propozimin tim. Kjo e bëri Kadriun të ndjehet i
2 përçmuar dhe të përfshihet fillimisht me Bashkim Spahiun,
3 Muhamet Hajredini, Sadik Halitaj dhe Megjit Halitaj, të cilët
4 në atë kohë po bënë punë destruktive duke lavdëruar qeverinë
5 dhe përbuzur UÇK-në. Kadriu nuk ishte tip i tillë por është
6 manipuluar nga njerëzit që ishin nën urdhrat e Fadil Gecit.
7 Fadil Geci ishte nga Llausha, anëtar i LDK-së ... i cili
8 punonte në favor të qeverisë të FARK-ut dhe të LDK-së që pati
9 pasoja të mëdha.”

10 “Për habi, më vonë, Rushit Haliti gjithashtu u përfshi në
11 këtë punë. Ai ishte intelektual të cilin nuk do ta lidhja
12 kurrë me pacifistët meqenëse vazhdimisht kishte qenë kundër
13 tyre deri në atë moment. Nuk e di pse, por me kthimin e tij
14 nga Shqipëria me Shaban Abazin ai mori pjesë, u përfshi në
15 këtë aktivitet.”

16 Pyetja ime është: E njeh Kadri Halitin?

17 PË. Po, e njoh mirë.

18 PY. Luftoi gjatë luftës ai?

19 PË. Po.

20 PY. Ku luftoi?

21 PË. Në territorin e Kastriotit, një fshat aty në komunën e
22 Skënderajt me rrethi. Është një djalë shumë i mirë, një
23 familje shumë e mirë. E ka kry detyrën e vet me nder, qysh i
24 ka hije çdo shqiptari.

25 PY. A e di nëse Bashkim Spahiu, Muhamet Hajredini, Sadik

1 Halitaj dhe Megjit Halitaj kanë luftuar edhe ata gjatë luftës?

2 PË. Po edhe një herë, këta struktura e organizimit në nivel
3 të Drenicës. Një muaj përpara janë bë -- u bë rifreskimi. Janë
4 zgjedhë të gjithë njerëzit me vota. Dhe këta kanë qenë
5 njerëzit që kanë mbrojt shtetin e Kosovës. Disa janë deklaru
6 haptas, disa në qetësi kanë kry detyrën ashtu qysh u preferu.
7 E këta janë deklaru haptas jemi në atë drejtim. Tash po del.
8 Unë i kam dit që janë njerëz që veprojnë, po tash e kam pa për
9 herë të parë ashtu. Këtë shkrim e kam pa për herë të parë.

10 PY. Po Rushit Halitin e njihni?

11 PË. Rushit Haliti është një profesor i mirë, një luftëtar i
12 mirë, një burrë i mirë me të gjitha të mirat në interesin
13 ashtë nder me pas një asi djali. Doktor i një lamie të
14 shkencave ekzakte. Dhe i kompletum komplet me të gjitha të
15 mirat.

16 PY. Po Shaban Abazin e njeh se edhe ai përmendet këtu në këtë
17 fragment?

18 PË. Po, po, e njoh. Jo shumë, po e njoh edhe atë si fytyrë e
19 njof. A Rushitin e njoh mirë.

20 PY. Ky fragment thotë që juve propagandonit në favor të
21 qeverisë së FARK-ut dhe të LDK-së. Keni qenë mbështetës i
22 qeverisë FARK-u dhe LDK-së në periudhën e prillit, siç
23 përmendet këtu 25 prillit?

24 PË. Kush ka thënë si bëj propagandë, po unë jam kanë vetë
25 faktori kryesor që i kam fillu tëna proceset aty. Unë jam kanë

1 përfaqësues i shtetit. Unë jam kanë kryetar i referendumit për
2 pavarësi, komision për referendum. Cili? Kush bën propagandë?
3 Ata që mbrojnë kushtetutën, shtetin ose ata që janë jashtë
4 saj? Propaganda a kanë në anën e kundërt jo në anën time. Unë
5 e kam rujt Drenicën edhe shqiptarinë për mos me u vra ndër ne
6 veti në bazë të udhëzimeve të presidentit Ibrahim Rugova. Unë
7 e marr atë përgjegjësi që ashtu kam vepru. Edhe çdo gjë që ka
8 qenë e dëmshme, i kam hjek prej sistemit në atë kohë në
9 Drenicë.

10 PY. Dëshmitar, këtu thuhet 25 prill po vitin nuk e shohim. Po
11 u përmend dhe Abedin Rexha. A mund të na e kujtoni kur ka
12 vdekur Abedin Rexha?

13 PË. Të lutem, para juve do të bëjmë një sqarim e mos, po një
14 lami jeni profesionalista të gjithë, Gjykatë e nderuar.

15 PY. Dëshmitar, ju lutem përgjigjuni pyetjes. A e mbani mend
16 se në ç'vit, kur ka vdekur Abedin Rexha?

17 PË. Abedin Rexha nuk është vra zyrtarisht, nuk është vra.
18 Edhe kjo unë mendoj ju duhet me i hjek prej kreje. Ajo është
19 marrë mjekësia ligjore, grupi i ekspertëve të EULEX-it dhe
20 abduksioni dhe u kry. Unë mendoj si jurist ashtu.

21 PY. Ndoshta, Dëshmitar, mbase ka pas problem me përkthimin.
22 Unë ju pyeta vetëm se kur vdiq Abedin Rexha. Në 1998, apo jo?

23 PË. Mua mue mu tha kur është vra, këtu në vesh tem. Dhe unë e
24 shpjegova, kërkoj falje, e shpjegova qysh është realiteti.

25 PY. Kur, në ç'vit vdiq Abedin Rexha?

1 PË. Kjo ka qenë 1998 diku, domethënë, janë datat. Këtu tek ju
2 kam kërku falje për data prej juve. Janë datat publike 100
3 mijë herë, po jam i dobët në data.

4 Z. PACE: [Përkthim] Kërkojmë, të nderuar Gjykatës,
5 pranimin e kësaj faqeje.

6 Z. DIXON: [Përkthim] Kundërshtojmë. Kjo faqe fillon siç e
7 përmendi Avokati i Prokurorisë, "Në 25 prill..." Po thotë që
8 nuk jepet viti. Pastaj vazhdon: "Unë shkova të shikoja..." Çdo
9 të thotë me "Unë", sepse dëshmitari nuk u pyet për këtë "Unë",
10 kush është ky "Unë". Pra, për kë është fjala?

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, e
12 kuptuam.

13 A mund ta sqaroni çdo të thotë se kush është "Unë"?

14 Z. PACE: [Përkthim]

15 PY. Dëshmitar, e dini kush e ka shkruar këtë?

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përgjigjuni
17 pyetjes.

18 DËSHMITARI: Po. Unë mendova për afërsisht si ju, se ai që
19 thotë "Unë", "Unë, Shaban Zyhrani". "Unë" u dike në bazë të
20 asajna dhashë atë përfundim. "Unë, Shaban Zyhrani". A ke, a
21 është për q'atë? Do të thotë, në bazë q'asaj fjale unë e
22 kuptum kush a kanë aty. Gjatë shkrimit e përmend fjalën "Unë",
23 Shaban Zyhrani edhe po dihet që ai ka qenë.

24 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, Dëshmitar.

25 Nëse më lejoni, dua t'i përgjigjem kolegut tim.

1 Do të citoj nga materiali me numër F001, ku thuhet në
2 paragrafin 11:

3 "Pranimi i një dokumenti nuk kushtëzohet nga provat e
4 identitetit të autorit të atij dokumenti."

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
6 shumë.

7 Dokumenti U002-3545 deri në U002-3558 është dokumenti që
8 citohet. Faqja që pranohet është U002-3550.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo faqe do të marri
10 numrin prova materiale P01748. Aktualisht është e klasifikuar
11 si konfidenciale.

12 Z. PACE: [Përkthim] Mund të bëhet publike.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të
14 klasifikohet si publike.

15 Z. PACE: [Përkthim] Të heqim këtë dokument, ju lutem. Dhe
16 të vendosim në vend të tij dokumentin që tani ka një numër P.
17 Numri P është P01742. Dhe dua që të shkojmë në faqen 053038.
18 Dhe përbri asaj të vendoset përkthimi në anglisht, që besoj ka
19 numrin tani P0142-ET. Faleminderit.

20 PY. Dëshmitar, ky material është diskutuar gjatë intervistës
21 suaj me ZPS-në. Lidhur me këtë materialin që është këtu thotë
22 që ju e dhatë raportin dhe dikush e shkroi.

23 Z. PACE: [Përkthim] Dhe nëse është e nevojshme bëhet
24 fjalë për Pjesën 6 të intervistës.

25 PY. Në ekran shohim fjalët e mëposhtme:

1 "- Drenica e mirëpret krijimin e parlamentit."

2 Pyetja ime është: Ju kujtohet që të keni përshëndetur
3 publikisht krijimin e parlamentit në 1998?

4 PË. Po. Edhe u kanë nder i madh me i përshëndet të gjithë ata
5 që kanë mend e që ia dojnë të mirën Kosovës.

6 Z. PACE: [Përkthim] Tani dua që të kalojmë në faqen
7 053045 të njëjtit dokument në shqip dhe në anglisht është
8 8087. Faleminderit. Ta zmadhojmë pjesën e fundit të faqes
9 qoftë në shqip qoftë në anglisht.

10 PY. Dëshmitar, është faqe nga i njëjti dokument që është
11 diskutuar në deklaratën tuaj të mëparshme lidhur me të cilën
12 thoni që duhet të kem dhënë një intervistë në atë kohë.

13 Z. PACE: [Përkthim] Është Pjesa 6.

14 PY. Ju thoni që përmend qershorin, 2 qershorin dhe i jeni
15 referuar Gazetës Shqiptare. Ju kujtohet të keni dhënë një
16 intervistë për Gazetën Shqiptare në atë kohë?

17 PË. Po, më kujtohet. Kam dhënë edhe për shumë tjera, por që
18 këtu qenka emni im edhe është e vërtetë që i kam dhënë
19 intervistë. Edhe kam përshëndet kuvendin, kam kërku
20 urgjentisht me u formu ato organe legjitime që janë në interes
21 tonë të përgjithshëm. Zgjedhjet i kam përshëndet. Edhe a i
22 dini pse i kam përshëndet? Se shumë herë ka kritika në atë
23 drejtim e tash ju du me ju tregu. A bën?

24 PY. Unë do të lexoj përgjigjen tuaj në faqe. Mund ta ndiqni
25 në shqip apo të dëgjoni përkthimin:

1 "F. Geci. Së fundi, dua të pyes përsëri që kuvendi i
2 Kosovës të mblidhet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe çdo
3 gjë të vendoset në rrugën e duhur që të mos dukemi sikur nuk
4 jemi në rregull, mos dukemi qesharak përpara botës sepse kjo
5 ka ardhur nga votat e popullit.

6 "Ata e kanë zgjedhur vetë dhe populli nuk gabon kurrë."

7 Dëshmitar, pyetja ime është: Çfarë "institucioni i
8 vetëshpallur që nuk ka marrë asnjë votë nga populli", për
9 cilin institucion e kishit fjalën?

10 PË. Edhe një herë, këtu kanë qenë dy grupe: Njëri, që
11 përfaqësoj këtu unë sot, që u kanë i zgjedhur nga vota e
12 popullit edhe tjetri që kanë thënë këta nuk janë legjitim,
13 këta nuk bën me u përgjigje, përgjigjëm na. E ai është grupi i
14 LPK-së i ardhur nga mërgata e që disa janë këtu sot. Dhe ne u
15 dashtë me bë çka është e mundshme me ruajt unitetin brenda
16 popullit. Unë e kam atë përgjegjësi edhe ato të gjitha të
17 metat që kanë qenë, grushti bolshevik që e kemi hjek me ju
18 tregu botës që nuk jem fundamentalistë, që nuk jem terroristë.
19 E kam vepru edhe kam hjek pi Drenice, jam unë që e kam hjek.
20 Dhe kam bë një mirë që u kanë në interes tonë të përgjithshëm.
21 Me grusht mirëprita Amerikën me na ndihmu. Kujna i ka konvenu
22 kjo? Veç armikut tonë. Kujna u ka dashtë mos me -- okej.

23 PY. Dëshmitar, në transkript thuhet që:

24 "...anëtarët e LDK-së disa janë të pranishëm këtu."

25 E kishit fjalën për ata të LDK-së apo për njeri tjetër?

1 PË. Jo, e kam për të LPK-së. LPK-së edhe të kreut që i thotë
2 vedit UÇK.

3 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

4 Z. PACE: [Përkthim] Sekretare, mund ta hiqni nga ekrani
5 dokumentin.

6 PY. Dëshmitar, në intervistën që na ke dhënë, ke thënë lidhur
7 me Komunikatën 59 dhe po lexoj nga Pjesa 2, faqet 13 dhe 14:

8 "...e gjithë Drenica u ngrit në këmbë për të nënshkruar
9 deklarata që kjo komunikatë ishte e rreme, si kundër Sami
10 Lushtaku dhe të gjithë përfaqësuesit e Drenicës kanë thënë dhe
11 ky është dokument zyrtar."

12 Z. PACE: [Përkthim] Dhe ju lutem paraqiteni këtë dokument
13 me numër P00161, bashkë me versionin në anglisht në ekran. Të
14 shikojmë faqen e parë të dy varianteve.

15 PY. Dëshmitar, hidhini një sy shqipes, variantit në shqip për
16 një moment.

17 Z. PACE: [Përkthim] Të shikojmë në fund. Dhe tani të
18 shikojmë faqen e dytë në të dy versionet.

19 PY. Dëshmitar, e kishit parë dokumentin në shqip përpara se
20 t'jua tregoja javës që shkoi, m'u përgjigjuni po apo jo?

21 PË. Po. Këtë dokument e kam pa. E ka pas në dorë vëllau im,
22 Ganiu edhe ka punu shumë për këtë drejtim. Dhe Komunikata
23 numër 59 është sherri më i madh i lym me benzinë që e ka kallë
24 jo veç Drenicën po dhe ma lart. E ajo komunikatë është kanë e
25 rreme, shpifëse, dashakeqe që i ka bë dëm të gjithëve, po

1 familjes teme i ka krijuar shqetësime të mëdhaja edhe me pasoja
2 të mëdhaja. I kam pas dy shokë të vramë, dy vëllaznit të
3 plagum.

4 PY. Dëshmitar, kjo është deklarata e nënshkruar për
5 Komunikatën 59 që ke përmendur në intervistën që i ke dhënë
6 ZPS-së kur ta kam tregu dokumentin?

7 PË. Po. Kjo është deklarata që e kam pa, e ka ruajt vëllau
8 im, Ganiu. Është shumë i kujdesshëm në këtë drejtim me letra
9 ma shumë se unë shumë. Dhe e falënderoj që e ka pas kujdes për
10 këto se është në interes të gjithëve dhe tonë. Familjes tem
11 personalisht edhe Drenicës në përgjithësi e të Kosovës,
12 komplet shqiptarisë, me dit kush është ai që e ka lëshu
13 Komunikatën 59 dhe kush janë vëllazërit Geci, familja Geci, që
14 u barts e të gjitha proceseve prej ka 1945 edhe deri në ditën
15 e sotit. Edhe sot kemi përfaqësues tonin në parlamentin e
16 Kosovës.

17 Z. PACE: [Përkthim] Ky dokument mund të hiqet nga ekrani.
18 Dhe ju lutem paraqitni dokumentin SITF00243024 deri në
19 SITF00243029 bashkë me versionin në anglisht, që ka të njëjtin
20 numër ERN, po në fund ka -ET. Dhe të shohim faqen e parë të të
21 dy dokumenteve, ju lutem.

22 PY. Dëshmitar, ky është një artikull nga gazeta Zëri.

23 Z. PACE: [Përkthim] Domethënë, në qoftë se do të kalojmë
24 në fund të faqes besoj që do ta shikoni që ky është një
25 artikull i gazetës Zëri.

1 PY. Është artikulli që mban datën 30 tetor 1999. Në qoftë se
2 do shkojmë më sipër në faqe, mund të shihni që artikulli ka të
3 bëjë me një intervistë me Rexhep Selimin. A e ke parë këtë
4 artikull përpara se t'ju a tregoja unë përpara një jave,
5 Dëshmitar?

6 PË. Jo, nuk e kam pa. Veç kam dëgju që folshin atëherë.

7 Z. PACE: [Përkthim] Të shohim faqen SITF00243028 në shqip
8 dhe aty dua që të zmadhoni kolonën e fundit, kolona e katërt
9 në të djathtë, ndërkohë që në anglisht duhet të jetë tek faqja
10 7. Dëshiroj që tek versioni në anglisht të zmadhoni gjysmën e
11 parë të faqes. Faleminderit. Në anglisht duhet të kalojmë tek
12 faqja 7. Dhe një faqe më poshtë.

13 Ndërkohë që në shqip duhet ta zvogëloni pak faqen në
14 mënyrë të tillë që të përqendrohemi tek e gjithë kolona e
15 katërt. Besoj që për momentin mjafton kaq.

16 PY. Dëshmitar, do t'ju lexoj nga anglishtja dhe mund të
17 dëgjoni përmes përkthimit çfarë po lexoj unë ose mund ta
18 lexoni dhe vetë. Pjesa që do ju lexoj ka të bëjë me një
19 përgjigje që jep Rexhep Selimi:

20 "Kur flasim për bërthamat e para të UÇK-së, nuk duhet të
21 harrojmë Abedin Rexhën - Sandokanin. Abedini edhe tre
22 komandantë të tjerë kanë vdekur në betejë. Zona Operative e
23 Drenicës dha katër komandantë brigdash në këtë luftë: Abedin
24 Rexhën, Fehmi Lladrovcin, Ilaz Kodrën dhe Mujë Krasniqin.
25 Vrasja e komandantit Sandokan është një vrasje në vazhden e

1 vrasjeve nga tradhtia e njerëzve të mëdhenj. Abedin Rexha u
2 vra nga dora e tradhtarit në pritë, ashtu siç kemi raste gjatë
3 historisë sonë ku njerëzit e mëdhenj vriten nga tradhtarët.
4 Kjo nuk bën të fshehët, përkundrazi në atë moment ku fshihet
5 bëhet një atentat i dytë mbi Abedinin. Prandaj duhet që të
6 themi të vërtetën lidhur me Abedinin. Vrasja e Abedinit është
7 përfshirë në një komunikatë, në Komunikatën 59, ku thuhet që
8 ai është vrarë nga Geci. Pse është bërë kjo vrasje? Pra,
9 ndërkohë Abedini mendohej që ishte një person shumë i
10 rëndësishëm dhe një shtyllë shumë e rëndësishme e UÇK-së në
11 atë kohë, një shtyllë që njerëzit dëshironin që ta hiqnin. Kjo
12 është arsyeja që pse njerëzit që ishin kundër UÇK-së, që dhe
13 këtu e kam fjalën për forcat e Bukoshit, FARK-un, në fakt
14 ishin kundra Abedin Rexhës dhe për këtë arsye e vranë Abedin
15 Rexhën. Abedin Rexhën e vrau Gani Geci. Duhet që të bëhet
16 analiza: Kush është vrarë? Është vrarë një komandant brigade,
17 një ndër themeluesit e UÇK-së në Drenicë, themeluesi i
18 Brigadës 112, një person me kompetenca dhe një person që
19 njihej nga popullata. Pse duhet ta fshehin këtë? Ne duhet të
20 themi të vërtetën ...”

21 Dëshmitar, ju thatë që nuk e keni parë artikullin më
22 përpara por që keni dëgjuar lidhur me përmbajtjen e tij. A
23 keni dëgjuar lidhur me mendimin ose opinionin e Rexhep Selimit
24 sa i takon vrasjes së Abedin Rexhës nga vëllai juaj në tetor
25 të 1999, Dëshmitar?

1 PË. Po, po. Rexhep Selimi ka gabu këtu që e ka shkruar se po e
2 din ky që nuk është ashtu. A rrenë. Sa ai rrenë është. Komplet
3 është rrenë. I ka vu, është përfaqësues i LPK-së i një
4 drejtimi të kundërt, e ka shkruar për palën tjetër që është
5 kështu ose ashtu. Po kjo nuk është e vërtetë. Është rrenë.
6 Krejt është rrenë.

7 Forcat e Bujar Bukoshit, të Qeverisë, unë, të Kosovës,
8 kanë qenë forca të rregullme brenda sistemit shtetnor të
9 Kosovës. Qa ai shtet që e kem pas.

10 PY. Vëllai juaj, në tetor të 1999, etiketohet si tradhtar dhe
11 si vrasësi i një komandanti të UÇK-së. Në këtë kohë,
12 domethënë, në tetor të 1999, një vit pas betimit të
13 Komunikatës 59, a ju kujtohet në qoftë se vëllai juaj, ju vetë
14 apo familja juaj ende kishit, vuanit pasojat negative të kësaj
15 komunikate --

16 PË. Jo që i vuanim pasojat --

17 PY. -- a mund të na e thoni dot këtë gjë?

18 PË. -- po na dhe sot nuk është shfuqizuar. Edhe sot kemi pasoja
19 në atë drejtim. Kjo po vërehet vetëm në atë deklaratë që e ka
20 thënë Rexhep Selimi, sigurisht, në bazë të Komunikatës 59 u
21 thirr. Se e kam pa më përpara që e ka kundërshtuar ato në atë
22 drejtim. Dhe unë po them që edhe sot i kem pasojat e asaj
23 komunikate. Familja jonë vuan në atë drejtim deri sot, e din
24 opinionin krejt kosovar e shqiptar që Komunikata 59 u kanë e
25 rrejshme dhe shpifëse.

1 E ai shpifës kush a, kam pas qejf me ardhë me i pa në sy
2 këtu e me këqyr cili është shpifësi që ka shkru për vëllezërit
3 Geci. Një familje që në të gjitha proceset u kanë e para në
4 Drenicë me familjarë tjerë që kanë vlerë në nivel të Drenicës
5 dhe ata kanë pas pasoja të njëjta. Kam qejf me i pa në sy edhe
6 po kam qejf me i pa, me i ni kush është ai. E Rexhepi e ka
7 tregu. Faleminderit Rexhep Selimi për atë fjalën që ke tregu
8 kush e ka shkru komunikatën. Faleminderit që e ke thënë një të
9 vërtetë.

10 Ke punu ma shumë se tjerët, Rexhep Selimi, ke punu. Edhe
11 një fjalë ta fali që e ke thënë. Ti e di që s'a q'ashtu. Mirë
12 e din se Gani Geci s'a tradhtar, por është njëri ndër
13 luftëtarët e parë. Po ke dashtë me thënë nuk a koha.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
15 thjesht përgjigjuni pyetjeve dhe mos ju drejtohuni personave
16 të tjerë që janë në sallën e gjyqit.

17 Z. PACE: [Përkthim]

18 PY. Dëshmitar, shkurtimisht, ku, sipas jush, Rexhep Selimi ka
19 thënë të vërtetën dhe ka thënë emrin e personit që ka shkruar
20 Komunikatën 59 ose në çfarë rasti e ka dhënë këtë informacion?

21 PË. Informacionin e kam pa bashkë me ju, ma ke dhënë
22 deklaratën ti të Rexhep Selimit e kam pa. Me ty atë ditë e
23 pamë që ka thënë edhe në TV drejtpërdrejt një emision të TV
24 Dukagjinit, se Komunikatën numër 59 e ka shkru një dashakeq,
25 po ai është Hashim Thaçi. Ai dashakeq që i ka bë dëm Drenicës

1 në këtë komunikatë për një interes tina personal me largu nga
2 skena vëllezërit Geci, sikurse i largoi Serbia familjen
3 Jashari. Dhe me qenë i lirë me vepru ka don. Por ka gabu. Ka
4 gabu shumë. Ai mentalitet ka qenë sllav, rus, e nuk e ka ditë
5 që është Amerika, ka me marrë fund si një ditë këtu që jem e
6 kemi me u pa në sy edhe ka me u turpnu për këto punë që i ka
7 bë.

8 Z. PACE: [Përkthim] Të kalojmë tek faqja tjetër në të
9 dyja dokumentet në shqip dhe në anglisht. Te versioni në shqip
10 do kërkoja që të zmadhohej kolona e dytë dhe kolona e tretë,
11 Ndërkohë që në versionin në anglisht, do të kërkoja që të
12 zmadhohej pjesa e mesme, pjesa e mesit të faqes.
13 PY. Do të lexoj nga anglishtja, Dëshmitar. Dhe mund ta
14 dëgjoni përmes përkthimit ose mund të lexoni. Atëherë do
15 filloj nga pika ku: "Personi që ka vrarë Abedin Rexhën ka
16 dashur të më vriste dhe mua". Këtë e ka thënë Rexhep Selimi në
17 intervistë të 1999 që po diskutonim pak më herët.

18 "Selimi: Edhe unë personalisht kam qenë në rrezik, se
19 personi që ka vrarë Abedin Rexhën ka organizuar një përpjekje
20 për të më marrë dhe jetën mua, në të njëjtin vend ku është
21 vrarë Abedini. Unë kam mbijetuar për shkak të mungesës së
22 kompetencës së tyre. Ata nuk kanë gjetur njerëz që kanë qenë
23 mjaftueshmërisht të aftë për të realizuar këtë sulm."

24 Dëshmitar, a mund të na thoni për kë e ka fjalën Rexhep
25 Selimi kur ka thënë që ai vetë ka qenë në rrezik vrasjeje, në

1 qoftë se do i referohem kësaj që unë sapo lexova nga
2 dokumenti, për kë e ka fjalën Rexhep Selimi?
3 PË. Në bazë të asaj që po e thoni ju, nga e njëjta dorë, unë
4 po e di që e ka përmend, sigurisht, ja familjen, ja vëllaun,
5 q'aty dikund ka mendu. Mund të jetë ndryshe, unë nuk e di. Po
6 për këtë këta e dinë diçka, po edhe Rexha, a ka pas ndonjë
7 zënkë me vëllezërit Geci, a ka pas ndonjë kundërshtim
8 nganjëherë ku a në Likovc. Hashimi e din mirë kur ka pas o ça
9 i ka thënë. Dhe këta e dinë ma mirë. Unë nuk di.

10 Vëllau e din. Nëse u këtu një ditë, ua thotë të tëna.

11 PY. Për veç këtij dokumenti, a keni dëgjuar ndonjëherë për
12 ndonjë pretendim të ngritur nga Rexhep Selimi për personat të
13 cilët janë përpjekur që ta vrasin atë, për shembull, që mund
14 të kenë qenë anëtarë të familjes tuaj ose vëllau juaj, Ganiu,
15 ke dëgjuar ndonjë pretendim tjetër përveç këtij?

16 PË. Po kam dëgjue dhe aso. Kam dëgju që përfaqësuesit e
17 qeverisë po fluturojnë. Kam dëgju që kush pshton prej tyre
18 s'ka. Edhe ajo u kanë koha q'ashtu mendojshin. Edhe më mirë që
19 kam ndëgjue s'ka pas, s'janë kanë profesionalista, s'ia kanë
20 qëllu me bë ndonjë sherr të madh në shqiptarë. Po më vjen mirë
21 edhe aty lidhet kjo që thotë Rexha që s'janë kanë
22 profesionalista edhe nuk u pshtu Rexha. Shyqyr që u pshtu.
23 Shumë mirë u bë që u pshtu.

24 Krejt familjen e Rexhës e njoh, komplet. I kemi pas
25 veprimtarë, bashkëveprimtarë mixhën e tina. Veprimtarë tjerë

1 Ismet Rrahmanin, Hysni Shabanin. Kanë qenë veprimtarë të LDK-
2 së të organizum. Hysniu ka qenë delegat i vramë në 1998, që e
3 përmend Sylejman Selimi që e kam njërin ndër themeltarët e
4 Ushtrisë Çlirimtare në Aqarevë. Ka qenë delegat i kuvendit me
5 pushkë në atë kohë zyrtar. Dhe është mirë që ka qenë. Edhe
6 është djalë i mirë. Edhe Sylejmani edhe ai, shumë djalë i
7 mirë.

8 PY. Dëshmitar edhe një herë e ngre dorën sepse po shkon
9 përtej pyetjes që ju bëra, nuk kemi shumë kohë.

10 Z. PACE: [Përkthim] Kështu që për këtë arsye kërkoj që
11 këtë faqe ta pranojmë si një provë materiale, është faqja për
12 të cilën foli dëshmitari.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
14 kundërshtime?

15 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.
16 Kundërshtoj sepse dëshmitari tha që këtë dokument nuk e ka
17 parë më përpara. Dhe jo vetëm kaq, po ashtu nuk kemi asnjë të
18 dhënë, nuk kemi asnjë dëshmi nga Prokuroria sa i takon lidhjes
19 që ka ky dokument me Rexhep Selimin. Kështu që nuk jepet
20 ndonjë rrethanë që ka të bëjë me rëndësinë.

21 Kështu që për këtë arsye ne parashtrojmë që në këtë fazë
22 ky dokument nuk duhet pranuar.

23 Z. PACE: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se do të më lejoni
24 që t'i jap një përgjigje kolegut.

25 Tani dua që të citoj nga vendimi në parashtrim e

1 protokolluar F01983 nga Trupi Gjykses të nxjerrë më 5 dhjetor
2 2023 dhe po lexoj këtu paragrafin 40:

3 "Lidhur me artikujt që kanë të bëjnë me deklaratat e UÇK-
4 së dhe/ose të akuzuarit, Trupi Gjykses vëren se natyra e
5 dëgjimit në nivel të dytë të këtyre dokumenteve dhe kufizimet
6 që mund të kenë këto për aftësinë e Mbrojtjes për të
7 kundërshtuar ose për të vënë në pikëpyetje përmbajtjet e
8 këtyre dokumenteve do të vlerësohet kur të përcaktohet pesha e
9 provës përkatëse. Trupi Gjykses për pasojë është i bindur që
10 vlera provuese *prima facie* e këtyre dokumenteve nuk zhbëhet
11 nga efekti paragjykses që lidhet me to."

12 Mendoj që kjo është situata dhe këtu përshkruhet e gjithë
13 situata sa i takon pranimit të këtij dokumenti.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
15 gjë tjetër për të thënë nga palët?

16 Nëse nuk ka gjë tjetër për të shtuar, atëherë ne në
17 pajtim me atë çfarë kemi vendosur më përpara, mendojmë që
18 është konsistente që të pranohet SITF00243024 deri në
19 SITF00243028 dhe 29. Po kërkoni që të pranohen dy faqe, z.
20 Pace, apo jo?

21 Z. PACE: [Përkthim] Për të konfirmuar janë faqen 30243028
22 dhe 3029.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

24 Ju lutem, caktojini një numër.

25 DËSHMITARI: Ju lutem.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
2 vazhdoni, Sekretare.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Atëherë në qoftë se
4 mund të shtoj, përkthimet përkuese në anglisht për faqen e
5 parë që është SITF00243024, për faqen 5 në shqip është
6 dokumenti në anglisht SITF00243030 dhe për faqen 6 në shqip
7 përkthimi në anglisht është SITF00243031. Këto faqe do të
8 pranohen si provë P01749. Aktualisht janë klasifikuar si
9 konfidenciale.

10 Z. PACE: [Përkthim] Mund të riklasifikohen si publike.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshiron të
12 thuash diçka, Dëshmitar?

13 DËSHMITARI: Kjo kaloi ndoshta është një dokument shkurt.
14 Në lidhje me këtë, krerët e Drenicës, Sylejman Selimi --

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

16 DËSHMITARI: Po në lidhje me qëta është.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjë
18 pyetje Prokurori, pastaj mund t'i përgjigjesh, Dëshmitar.

19 Z. PACE: [Përkthim]

20 PY. Dëshmitar, do kërkoj që të paraqitet një tjetër dokument
21 në vend të dokumentit që kemi. Dhe pastaj besoj që do ta
22 kuptosh që pse nuk është e nevojshme që ta shtjelloni më tej
23 përgjigjen tuaj.

24 Z. PACE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të paraqesë
25 në ekran provën P00760, përbri dokument ne anglisht që mban

1 numrin 760-ET. 2. Më konkretisht dua që të paraqitet në ekran
2 faqja 076603. Faleminderit.

3 PY. Dëshmitar, dokumentin në të majtë të ekranit a e ke parë
4 më përpara sesa t'jua tregoja unë para një jave?

5 PË. Jo, nuk e kam pa, për herë të parë.

6 PY. Shohim që thuhet "Reagim" dhe thuhet që:

7 "Në një pjesë të intervistës së Rexhep Selimit, që ka
8 dhënë për revistën Zëri ... më datë 30 tetor..."

9 Dhe thuhet, domethënë, kemi disa persona që kanë
10 nënshkruar këtë dokument, shikojmë, për shembull, tek numri 1
11 dhe numri 2, më konkretisht është Sylejman Selimi.

12 Ju thoni që nuk e keni parë këtë dokument më përpara sa i
13 takon reagimit ndaj intervistës së Selimit. Po për sa i takon
14 përmbajtjes së këtij dokumenti a keni dëgjuar më përpara,
15 Dëshmitar?

16 PË. Po. Është bisedu. Unë e kam bisedu vetë me Sylejman
17 Selimin dhe më ka thënë që "Ti e ki mirë, Rexha e ka keq edhe
18 do të reagojmë". Dhe i falënderoj këta, mjafton ky reagim këtu
19 që e kanë bërë për opinion që kanë thënë që çdo fjalë që e ka
20 fol Rexhep Selimi është shpifje se Gani Geci nuk është
21 tradhtar po luftëtar i orëve të para. Faleminderit pej gjithë
22 këtyne burrave këtu të Drenicës që janë djem të mirë dhe ia
23 kanë dashtë të mirën Drenicës në përgjithësi, po edhe
24 shqiptarisë në veçanti.

25 Edhe kanë thënë një vërtetë. Rexhepi u ngut, ku me dit

1 ato kohë, atëhere a kanë një kohë e ngut pak. Ka gabu ky, ka
2 bërë njeri edhe ai ka gabu. Duhet me e pranë që ka gabu, nuk a
3 mirë.

4 Z. PACE: [Përkthim] Ta heqim këtë dokument nga ekрани dhe
5 të shfaqet ndërkohë dokumenti 078549-01. Përbri këtij
6 dokumenti të shfaqet gjithashtu përkthimi në anglisht që mban
7 numrin 078459-01-TR-AT.

8 Në përkthimin në anglisht, do i kërkoja Sekretares të
9 kalojmë tek faqja 2. Do fillojmë me faqen 2. Ndërkohë që sa i
10 takon videos, dëshiroj që të filloj në minutën 01:04. Do
11 kërkoja që të transmetohet me zë dhe të transmetohet dhe për
12 publikun. Atëherë segmenti i videos që do të transmetohet
13 është nga minuta 01:04 deri tek minuta 01:59.

14 Nuk do ta shfaqim në ekran versionin në shqip, megjithatë
15 për të ndihmuar përkthyesit kjo jepet në pjesën 2 deri në 3 të
16 faqes 078459-01-TR-ET.

17 Do ta lexoj gjithësi tekstin në mënyrë të tillë që të
18 dëgjohet nga të gjithë personat që janë të pranishëm në të
19 dyja versionet.

20 PY. Atëhere a shikoni një video në të majtën tuaj, Dëshmitar?

21 PË. Po, po, po.

22 Z. PACE: [Përkthim] Atëherë, ju lutem dëgjoni përmbajtjen
23 e asaj që do thuhet.

24 [Luhet videoincizimi]

25 [Zëri] "Sapo e thotë pyetni ata. Ne i kemi pyet të gjithë

1 prandaj po ju pyes edhe juve.

2 "Z. Selimi: Jo, s'e keni pyet. S'e keni pyet. S'e keni
3 pyet Thaçin, për shembull.

4 "Moderatori: Po.

5 "Gazetari: Qysh s'e kemi --

6 "Z. Selimi: Ai ka mohu si i ka bë --

7 "Moderatori: Po.

8 "Z. Selimi: -- komunikatat a?

9 "Moderatori: Ne e kemi pyet për komunikatat".

10 "Z. Selimi: A ka thënë që s'i kam ba kurrë?"

11 "Gazetari: Absolutisht".

12 "Moderatori: Ka qenë -- jo. Ka kërku falje për veprimet -
13 -

14 "Z. Selimi: Kur e keni pyet ça ka thënë s'kam bë
15 komunikata?

16 "Gazetari: Po.

17 "Moderatori: Edhe këtu e kemi pyet. Ka pas po ashtu
18 dilema sikurse ju.

19 "Z. Selimi: I ka kërku falje Gani Gecit për Komunikatën
20 59.

21 "Moderatori: [Folës që flasin njëkohësisht] Të pyes. Po.

22 "Z. Selimi: Ata e dinë ma së miri arsyen e kërimit të
23 faljes.

24 "Moderatori: Edhe një herë".

25 "Po, po."

1 "Z. Selimi: Ka thënë që s'kam shkruajt komunikata Hashim
2 Thaçi?

3 "Moderatori: Tash, mos të kapemi për fjalë. Nuk e di
4 saktësisht çka ka thënë s'e kam shkruajt.

5 "Z. Selimi: Kjo a shumë me rëndësi me dit".

6 "Moderatori: Por --

7 "z. Selimi: Nëse ai thotë s'i kam shkrujt unë, atëherë
8 [Folës që flasin njëkohësisht] atë çka unë --

9 "Gazetari: Në kontekstin, në kontekstin që e ka thënë i
10 bien që është distancu prej tyne dhe thotë që nuk i ka shkru
11 asnjë prej tyne.

12 "Z. Selimi: Që s'është e vërtetë.

13 "Moderatori: Jo, unë mesa po kuptoj, z. Selimi --

14 "Gazetari: Në kontekstin --

15 Moderatori: -- ju po thoni që --

16 "Z. Selimi: Përgjigja ime --

17 "Moderatori: -- Hashim Thaçi ka kaluar në komunikata?"

18 "Z. Selimi: Përgjigja ime është kjo: Nuk është e vërtetë.
19 [Folës që flasin njëkohësisht]"

20 "Moderatori: Kur the Hashim Thaçi ka shkruar komunikata -
21 -

22 "Z. Selimi: Zoti Ermal" -

23 "Moderatori: -- dhe ju thatë edhe krejt normal. Hashim
24 Thaçi ka shkruar komunikata?"

25 "Z. Selimi: Hashim Thaçi? Po. Ka udhëheqë dhe drejtorinë

1 politike të këtij vendit dhe [Folës që flasin njëkohësisht]”.

2 “Moderatori: Dhe i ka shkruar komunikatat”.

3 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

4 PY. Përpara sesa të transmetonim një pjesë të kësaj videos

5 përpara një jave, këtë program a e keni pas parë ju,

6 Dëshmitar, ose a keni dëgjuar lidhur me të?

7 PË. Po, kam dëgju drejtpërdrejt. Rastësisht e kam çelë dhe e

8 kam dëgju unë vetë drejtpërdrejt.

9 PY. Do të lexoj atë që sapo dëgjuam sepse ishte shumë shpejt.

10 Dhe për procesverbal, në mënyrë të tillë që të reflektojë çdo

11 gjë do ta lexojë. Gazetari thotë:

12 “Ju thoni që duhet t’i pyesni ata. Ne i kemi pyetur të

13 gjithë ata po për këtë arsye po ju pyes dhe juve.

14 “Z. Selimi: Jo, ju nuk i keni pyetur ata. Nuk i keni

15 pyetur ata. Nuk e keni pyetur Thaçin, për shembull. A i ka

16 mohuar ai se i ka shkruar komunikatat?

17 “Gazetari: Po. Kemi pyetur në qoftë se i ka shkruar

18 komunikatat.

19 “Z. Selimi: Dhe çfarë ka thënë ai që nuk ka shkruar

20 asnjërën prej tyre?

21 “Gazetari: Është ai i ka kërkuar falje. Edhe ai ka pasur

22 dilemat e veta si puna jote.

23 “Gazetari: Ai i ka kërkuar falje Gani Gecit në

24 komunikatën 59.

25 “Z. Selimi: Unë e di shumë mirë arsyen sepse ka kërkuar

1 falje. Edhe një herë, a ka thënë Hashim Thaçi që nuk i ka
2 shkruar komunikatat?

3 "Gazetari: Tani mos të flasim për fjalët konkrete që ka
4 thënë se nuk e di ekzaktësisht se çfarë ka thënë.

5 "Z. Selimi: Jo, është shumë e rëndësishme që të dihet se
6 çfarë ka thënë konkretisht, sepse në qoftë se ai ka thënë që
7 nuk i ka shkruar këto komunikata atëherë ...

8 "Gazetari: Në kontekst ai tha që ka distancuar veten nga
9 përmbajtja e këtyre komunikatave dhe që nuk i ka shkruar ato.

10 "Z. Selimi: Kjo nuk është e vërtetë.

11 "Gazetari: Mesa e kuptoj unë ...

12 "Z. Selimi: Përgjigja ime është që kjo nuk është e
13 vërtetë.

14 "Moderatori: Hashim Thaçi a i ka shkruar komunikatat apo
15 jo?

16 "Z. Selimi: Hashim Thaçi?

17 "Moderatori: Po.

18 "Z. Selimi: Ai ka qenë drejtues i departamentit politik i
19 këtij vendi."

20 Dëshmitar, a ju kujtohet që dëgjuat këto fjalë gjatë
21 këtij programi që sapo patë?

22 PË. Po. Shumë mirë i kam dëgju edhe me vëmendje. Kanë qenë
23 domethënëse për neve. Kam kërku kohë të gjatë me dit, kem dit
24 ka ashtë një brum. Unë si personazh kam qenë në familjen e
25 Hashim Thaçi në Burojë mbas shkrumjes së Komunikatës 59. Unë

1 vetë kam qenë. Aty e kam taku --

2 PY. Dëshmitar, nuk dua të jem i pasjellshëm, por sikurse e
3 kujtoni, por edhe Gjykatësit e dinë që incidenti kur keni
4 shkuar në shtëpinë e Hashim Thaçit e keni dhënë të qartë në
5 dëshminë tuaj, kështu që nuk do ta përsërisim përsëri.

6 PË. Okej.

7 Z. PACE: [Përkthim] Kështu që tani për momentin --

8 DËSHMITARI: Pajtoj.

9 Z. PACE: [Përkthim] -- do i kërkoj Sekretares përsëri që
10 të transmetojë nga minuta 02:27 deri në minutën 03:35. Dhe në
11 anglisht do shkojmë tek faqja 4 do të vazhdojmë më tej në
12 faqen 5. E njëjta gjë është e vërtetë për versionin në shqip.
13 Atëherë do ta dëgjojmë një herë dhe pasi ta dëgjojmë unë do
14 lexoj tekstin për procesverbal në mënyrë të tillë që të jetë
15 plotësisht i zbardhur.

16 PY. E dëgjojmë, Dëshmitar.

17 [Luhet videoincizimi]

18 "Z. Selimi: Është shkru po tash mos ta -- përgjigjen.

19 "Moderatori: Edhe një herë, ma gjeni regjia deklaratën
20 presidentit Thaçi --

21 "Z. Selimi: Nëse thotë ai që s'kam shkru unë komunikatat

22 --

23 "Moderatori: -- për komunikatën e një --

24 "Z. Selimi: -- ja ua kam borxh një Gani Gecit, një
25 emision veç për q'atë punë.

1 "Moderatori: Po, a po e lexojmë?

2 "Gazetari: Mundem me e lexu ça ka thënë, z. Selimi, nëse
3 jeni i interesum. Po dhe nëse s'jeni, unë po lexoj.

4 "Z. Selimi: Jo boll më. Mirë është se na ka interesum
5 opinionioni s'po e njeh fort vallaj.

6 "Gazetari: Nuk mund t'i kujtoj, po thotë, të gjitha
7 deklarimet, por mund të them se gjatë luftës, sikur që ka edhe
8 sot, kanë ndodhur abuzime në luftën e UÇK-së dhe emrat e
9 individëve të caktuar. Janë lëshuar deklarata nga Banhofs për
10 të përçarë UÇK-në dhe për të krijuar konfuzion për t'i cënu
11 njerëzit.

12 "Z. Selimi: Saktë. Kjo është sapo e thatë edhe ju. Po.

13 "Gazetari: Domethënë, ai po e hjek përgjegjësinë prej
14 tij.

15 "Z. Selimi: Po.

16 "Gazetari: Edhe po thotë, Komunikata me numër 59 është
17 një komunikatë abuzuese që nuk i takon UÇK-së. Drejtori
18 politik ky i UÇK-së po thotë, është nxjerrë pa aprovimin e
19 shtabit të UÇK-së nga individë keqberës. Ça ka desh me thënë
20 me këto, ai e din ma së miri.

21 "Z. Selimi: Pajtohem.

22 "Gazetari: Edhe thotë është lëndu --

23 "Z. Selimi: Është me një fjali --

24 "Gazetari: -- është lëndu luftëtari i orëve të para të
25 UÇK-së Gani Geci dhe familja e tij dhe unë shpreh ndjesë dhe

1 keqardhje pse kjo deklaratë e disa të tjera abuzuese kanë
2 ndodhur. Që kjo është deklarata e Hashim Thaçit.

3 "Z. Selimi: Dëgjo. Me një fjali tij, me një pasus tij që
4 këtë deklaratë e ka shkruajt një individ dashakeq pajtohem
5 plotësisht.

6 "Moderatori: Por mund me shkruajt një --

7 "Z. Selimi: Po ai është Hashim Thaçi.

8 "Moderatori: Hashim Thaçi e ka shkruar Komunikatën 59?

9 "Z. Selimi: Komunikatën 59 është hartues dhe lëshues
10 është Hashim Thaçi."

11 Z. PACE: [Përkthim]

12 PY. Do lexoj dhe një herë transkriptin të asaj çfarë dëgjuam
13 dhe pastaj do t'ju bëj një pyetje, Dëshmitar.

14 "Moderatori: Regjia mund të na tregoni deklarinimet e
15 Hashim Thaçit sa i takon komunikatës për Gani Gecin?

16 "Z. Selimi: Në qoftë se ai thotë që ai nuk është personi
17 që ka shkruar komunikatën ... në të njëjtin program dhe për të
18 njëjtën çështje.

19 "Moderatori: A mund ta lexoni?

20 "Gazetari: Z. Selimi, në qoftë se jeni i interesuar mund
21 ta lexoj. Në qoftë se nuk je i interesuan nuk jua lexoj.

22 "Z. Selimi: Po, na duhet të dëgjojmë opinionin...

23 "Gazetari: Ai thotë, unë nuk më kujtohet të gjitha
24 deklarinimet që kanë ndodhur gjatë luftës, megjithatë, siç
25 ndodhë edhe sot e kësaj dite, ka disa persona që kanë abuzuar

1 emrin e UÇK-së. Disa deklarata janë lëshuar nga Bahnhof ... për
2 të shkaktuar ndarjen e UÇK-së dhe për të krijuar konfuzion
3 duke sulmuar njerëzit. Pra, ai është larguar, është distancuar
4 nga kjo komunikatë, nga Komunikata 59 dhe ka thënë që është
5 një komunikatë abuzive që nuk ka asgjë të bëjë me UÇK-në.
6 Drejtoria politike e UÇK-së, po thotë, që kjo është bërë nga
7 individë dashakeqë, pa miratimin e shtabit të UÇK-së. Ai thotë
8 që kjo është një lëndim për Gani Gecin, si një ndër luftëtarët
9 e orëve të para dhe shton më tej që kërkon falje dhe i vjen
10 keq sa i takon kësaj deklaratë dhe sa i takon deklaratave
11 abuzive të tilla si kjo. Këtë thotë z. Thaçi në deklaratën e
12 vet".

13 "Z. Selimi: Unë pajtohem me diçka në këtë fjali që kjo
14 është një deklaratë e cila është shkruar nga persona
15 dashakeqë. Megjithatë ky person është Hashim Thaçi.

16 "Moderatori: A e ka shkruar Komunikatën 59 Hashim Thaçi?

17 "Z. Selimi: Personi që e ka shkruar dhe e ka nxjerrë
18 Komunikatën 59 është Hashim Thaçi."

19 Dëshmitar, pyetja që kam për ju është kjo: A ju kujtohet
20 që e keni dëgjuar këtë përmbajtje në këtë emision, në këtë
21 program televiziv që ju kujtohet që e keni ndjekur?

22 PË. Po, ka qenë, e kam ndëgju me vëmendje dhe kam marrë frymë
23 kur e ditëm kush e ka shkru me emën e me mbiemën. Se mirë jam
24 kanë mirë që Rexhep Selimi e ka dit edhe u kanë i informum por
25 nuk ka tregu deri atëherë. U dashtë më herët me tregu.

1 Faleminderit Rexhë, që më tregove këtë vërtetë. Për ato tjerat
2 ti e din mbaje përgjegjësinë. Për këtë, të falënderojmë na,
3 të gjithë Drenica dhe shqiptaria. Se është në interes me dit
4 rrenën dhe të vërtetën. Ke punu në atë drejtim. Merre
5 përgjegjësinë për të keqen. Kjo është e mirë që nuk të
6 harrohet kurrë. Kurse ata që e kanë shkru komunikatën, thashë
7 më herët, s' du ta përsëris dy herë.

8 Duhet me i këqyrë, me i bë analizat që të dalin qysh
9 duhet taman.

10 Z. PACE: [Përkthim] Kërkojmë që video të pranohet bashkë
11 me transkriptin dhe përkthimin që përmenda.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
13 kundërshtim?

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk ka.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka nga
16 asnjë palë.

17 078549-01 plus përkthimin në anglisht dhe transkriptit
18 pranohen.

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Transkripti i videos
20 dhe përkthimi do të pranohen me numrin P01750. Klasifikimi i
21 tij është publik.

22 Z. PACE: [Përkthim] Ju faleminderit. Mund ta heqim atë
23 dokument. Tani dhe dua të shohim një dokument të ri me numër
24 U015-8734 deri në U015-9047 bashkë me përkthimin në anglisht
25 me numër U015-8734-U015-8935-ET I Rishikuar. Të shikojmë faqet

1 në të dy versionet, faqen e parë.

2 PY. Dëshmitar, këtë dokument në krahun e majtë e ke parë
3 përpara se ta tregoja unë javës që shkoi?

4 PË. Jo, kurrë. Për herë të parë e kam pa. Për herë të parë.

5 Z. PACE: [Përkthim] Të kalojmë në faqen 8747 në të dy
6 versionet.

7 PY. Dëshmitar, këtu shikoni që përmendet 2006 dhe emri midis
8 fillimit Jakup Krasniqit, pra, viti që shënohet 2006. E shikon
9 këtë, pra, viti kur është botuar 2006 dhe pastaj shkruan Jakup
10 Krasniqi.

11 PË. Po.

12 PY. Mbas ballinës dhe artit grafik.

13 PË. Po, po e shoh. S'i kam këqyrë këto fort. Këtu e kam parë
14 për herë të parë.

15 Z. PACE: [Përkthim] Të kalojmë në faqen 8814 në të dy
16 versionet dhe të zmadhojmë dhjetë rreshtat e fundit dhe do të
17 lexoj një pjesë. Faqja 8814. Faleminderit. Pak më poshtë.

18 PY. Dhe do të lexoj në anglisht nga "Mbi 200 ...", në shqip
19 fillon në "Në varrimin ..."

20 Unë do të lexoj dhe pastaj do ju bëj një pyetje. Është
21 nga i njëjti material:

22 "Në varrimin që do të organizohej në 3 mars do të marrin
23 pjesë mbi 200,000 njerëz nga mbarë Kosova. Ndoshta njerëzit
24 prisnin edhe kësaj radhe të paraqitej UÇK-ja. Këshilli
25 organizativ kishte arritur të vente rregull të cilin u munduan

1 ta prishnin vëllezërit Geci nga Llausha. Ata u përpoqën edhe
2 të eliminonin më të merituarit edhe në zgjedhjet e fundit të
3 degës së LDK-së. Por ishte ndërhyrja e Adem Jasharit që kishte
4 ndihmuar rrjedhën normale të kuvendit të Skënderajt. Ata patën
5 një duel jo të këndshëm me Shaban Shalën, i cili edhe për
6 kundër kërcënimeve nuk lejoi prishjen e rendit të
7 planifikuar.”

8 Pyetja e parë që kam është: Për kë tubim e ke fjalën ku
9 përmende që kanë marrë pjesë mbi 200.000 njerëz në varrim pra?
10 PË. Këtu merret -- po e kam pa për herë të parë. Jakup
11 Krasniqi nuk është njeri i pamënçëm, historian është,
12 historinë e dinë ai që të rrejshëm s’duhet me shkru se nuk a
13 mirë. Po këtu ka rrejt. Edhe ka shkru ça s’është për
14 vëllezërit Geci. Është diçka tjetër. Nëse më lejoni tregoj çka
15 është e vërteta.

16 PY. Së pari, përgjigju pyetjes sime, e dini se për cilin
17 procesion bëhet fjalë këtu?

18 PË. Për varrimin e rastit në Qirez e Likoshan që merret si
19 fillimi i luftës, i procesit, i masakrës së Serbisë. Dhe një
20 varrim që e ka organizue LDK-ja e ka organizu. Ne kemi qenë
21 organizatorë në Qerez e Likoshan në atë varrim bashkë me degën
22 e LDK-së në Drenas me Mehdi Bardhin. Ne kemi qenë
23 organizatorë. S’ka qenë Jakup Krasniqi, as ka qenë Shaban
24 Shala. S’ka qenë kërrkush në ato punë.

25 PY. Mjafton. Shikojmë që përmendet 3 marsi. Në çfarë viti ka

1 ndodhë ky procesion mortor?

2 PË. Në 1998.

3 PY. Në këtë pjesë pamë dhe kur e lexova e dëgjuat se
4 përmenden vëllezërit Geci nga Llaushani. Sipas jush për kë
5 është fjala?

6 PË. Kur përmenden "vëllezërit Geci" është shumë. Vëllezërit
7 janë shtatë. Të shtatit kanë marrë pjesë në atë varrim. Janë
8 kanë organizator të atij tubimi. Dhe aty u prishë kur ka fol
9 Luljeta Pula edhe ka thënë, një përfaqësuesja social-
10 demokrate, ka thënë fajet i ka Ibrahim Rugova për vrasje e
11 këto dhe masa u shoku. Dhe a kanë rrezik me i likujdu krejt
12 masa pi shikimit kur e ka përmend Ibrahim Rugovën që i ka
13 fajet. Nuk e ka shkru Jakup Krasniqi. U dashtë me shkru.
14 Historian është. Nuk është e vërtetë.

15 PY. A mund të na sqaroni se cila është Luljeta Pula - më fal
16 - përse po e fajësonte Luljeta Ibrahim Rugovën, shkurtimisht?

17 PË. Në atë kohë, u dashke mandati i kaloj parlamentit pej
18 1992 deri në 1998 u bë një kohë e gjatë. Dhe u dashke me bë
19 legjitimitet në popull me dit me kën me fol. Kushte të
20 jashtëzakonshme.

21 PY. Dëshmitar, për çfarë e fajësonte, shkurtimisht, Luljeta
22 Pulaj Ibrahim Rugovën? Me një fjali.

23 PY. Me një fjali thojke është fajtor Ibrahim Rugova për
24 vrasjen e këtyne personave që sot ka ndodhë. Ishin fushatë
25 zgjedhore që u dashtë me u mbajt zgjedhjet në atë kohë. E

1 përdori mortin për fushatë zgjedhore. Dhe Drenica ia dha
2 grushtin atyne që e kanë mendu. Që aty u dashta me dit që
3 s'janë kërkun edhe kën e kanë mbas vedi edhe Jakupi vetë.
4 PY. Për çfarë vrasje?

5 PË. Vrasjet që i vrajti Serbia familjarët në shtëpi. Katër
6 meshkuj të një familjeje, katër djem të Sheremetit. Reagimi ka
7 qenë i vet Sheremetit aty, një burri të mirë të Drenicës. Dhe
8 ja ka ndalë fjala Luljeta Pulaj Beqirit, janë ndalë, janë
9 blloku. Popullata ka bë kushtrim, heshtje të ashpër dhe ka
10 hjek pi bine Luljeta Pulën. Nuk e ka shkru Jakupi atë. Qaty a
11 rasti.

12 Z. PACE: [Përkthim] Të shkojmë tek faqja 8846 në të dy
13 dokumentet. Të kalojmë pak poshtë.

14 PY. Këtu, e shikoni, Dëshmitar, ke Abedin Rexha, ku fillon
15 aty Abedin Rexha?

16 PË. Mmm.

17 PY. Besoj që the po.

18 PË. Po, po.

19 Z. PACE: [Përkthim] Të kalojmë tek faqja tjetër 8847 dhe
20 të zmadhojmë paragrafin e parë në anglisht dhe në shqip dhe do
21 ta lexoj tani.

22 PY. "Gjatë ofensivës së verës 1998 kur më së shumti i duhej
23 Luftës Çlirimtare, i duhej frontit të luftës, ai u vra nga një
24 dorë krimineli. E vranë Abedinin por se vranë dot idealin e
25 tij, lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Vrasja tradhtare dhe e

1 pabesë e Abedin Rexhës, komandantit të Brigadës 112 Arben
2 Haliti, ishte humbje e madhe dhe për familjen Rexha, për
3 Brigadën 112 dhe për mbarë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.”

4 Dëshmitar, kush mendon se kujt ia ka atribuuar dëshmitari
5 vrasjen këtu?

6 Z. ELLIS: [Përkthim] Kundërshtoj, është spekulim.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

8 Z. PACE: [Përkthim]

9 PY. Dëshmitar, përgjigju.

10 PY. Edhe një herë pyetjen pak më detale të lutem.

11 PY. Nga ato që lexova, sipas teje, kujt ia referon autori
12 faktin që Rexhën e vrau dikush, kujt?

13 PË. Jo, Rexhën kjo a publike. Rexhën këta e kanë sulmue dhe
14 me komunikatë vëllaun, Gani Geci. Po unë e sqarova ato para
15 jush. Nuk di a ka nevojë edhe një herë. Ana ligjore e
16 mjekësisë e ka kry atë drejtim. Nuk du, nuk besoj që është në
17 interes.

18 PY. Mos e përsërit prapë, nuk ke nevojë. Unë dua vetëm të di
19 sipas teje, për kush, kë fajëson autori për vrasjen e Abedin
20 Rexhës?

21 PË. Autori fajëson drejtpërdrejt vëllaun tim Gani Geci e jo
22 veç Gani Gecin, po krejt familjen Geci edhe mua aty që kam
23 qenë edhe familjen komplet edhe komplet një organizim mundohet
24 me i bë kriminelë.

25 PY. Këtu shikojmë që përmendet vrasja e Abedin Rexhës si

1 tradhtar, pra dhe jo besnik. A është konsideruar vëllai jot
2 Gani dhe familja juaj si tradhtarë dhe të pabesë përpara
3 Komunikatës 59?

4 PË. Para Komunikatës 59 jem, kem qenë familja që i ka pri të
5 gjitha proceseve. Unë po e marrë veten që kam qenë unë ai që e
6 kam rrëzu sistemin, i kam pri proceseve në 1990. Kam qenë
7 kryetar i referendumit. Unë. Nuk ka pas aso. Kam qenë i pari i
8 atij vendi me shokë e rreth të mirë.

9 PY. Dëshmitar, të bëra një pyetje të thjeshtë. Gani Geci
10 është quajtur tradhtar dhe i pabesë përpara sesa të botohej
11 Komunikata 59 apo mbasi ajo u publikua?

12 PË. Mbasi Komunikata 59 u kry ky lajmërim. Kjo fyerje e
13 familjes që na ka bë dëm tanëve. Kurse Gani Geci është e
14 luftëtar edhe pushka e parë ndaj forcave serbe zyrtare është e
15 vëllaut të Gani Gecit menjëherë me urdhër të Adem Jasharit. Le
16 të kontestojë dikush, unë jam këtu. 1992 zyrtarisht e kam
17 përkrah shtetin e Kosovës, kushtetutën. Jam kriminel që e kam
18 mbrojt shtetin e Kosovë, kushtetutën.

19 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

20 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë
21 pranimin e këtyre faqeve që duhet t'i shtohen provës P00189 që
22 përmban ndërkohë faqet e pranuar nga libri.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
24 kundërshtim?

25 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo, nuk ka.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 8846 dhe 47
2 pranohen dhe do t'i shtohen P00189.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mesa kuptova unë kishte
4 dhe një faqe tjetër, U015-8814.

5 Z. PACE: [Përkthim] Në fakt ka dy faqe. 8747 është faqja
6 ku përmendet viti 2006 dhe e drejta e autorit. Dhe pastaj
7 është 8814, 8846, 8847.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Këto faqe do t'i
10 shtohen provës materiale P00189. Dhe klasifikimi, mesa di,
11 është publik.

12 Z. PACE: [Përkthim] Po, publik.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të
14 klasifikohet si publik.

15 Z. PACE: [Përkthim] Të heqim këtë dokument dhe të
16 paraqesim dokumentin U8 bashkë me përkthimin në anglisht që ka
17 të njëjtin numër ERN.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po e kërkuam
19 dhe një herë numrin.

20 Z. PACE: [Përkthim] 061381. Ky është numri i saktë.
21 PY. Dokumenti në të majtën është në shqip.

22 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta zmadhojmë pak.

23 PY. Dëshmitar, këtë dokument në anën e majtë e ke parë
24 përpara sesa ta tregoja unë javës që shkoi?

25 PË. Jo, nuk e kam pa. Për herë të parë e kam pa unë.

1 PY. Shohim se duket se është një postim në *Facebook* i 15
2 janarit nga një profil që duket se është, pretendon të jetë i
3 Jakup Krasniqit. Po të lexoj postimin.

4 "Përgjigje.

5 "Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi gjatë një interviste
6 me RTK-në në 13 shkurt 2019 i kërkoi falje Gani Gecit në
7 lidhje me Komunikatën 59 të UÇK-së.

8 "Siç thotë ai, zëdhënësi i UÇK-së gjatë intervistës tha
9 që e konsideroj të nevojshme për të nxjerrë, për të lëshuar
10 një deklaratë publike për faktin se shumë gjëra nuk janë, nuk
11 përputhen me realitetin.

12 "- Si udhëheqës politik i UÇK-së, Hashim Thaçi e di shumë
13 mirë se komunikatat nuk dalin, nuk lëshohen nga bahnhof ... po
14 të bëhej kështu do ta kishim kundërshtuar një tendencë të
15 tillë. Hashim Thaçi e di më së mirë se asnjë komunikatë që
16 përmban lista emrash apo emrin e Ibrahim Rugovës apo të tjerë
17 aktivistë janë lëshuar në emër të Shtabit të Përgjithshëm të
18 UÇK-së. Sepse ne do të ishim përgjigjur.

19 "- Hashim Thaçi e di shumë mirë se unë dhe komandantë të
20 tjerë të Zonës Operative të Drenicës ka kundërshtuar
21 Komunikatën 59 sepse mbështetet në pretendime të pasakta dhe
22 përçmuese lidhur me z. Geci.

23 "- Do ta kisha shprehur kundërshtimin tim po të ishin
24 bërë pretendime, akuza të tilla ndaj një familje shqiptare.

25 "- Hashim Thaçi e di shumë mirë se që nga 1998 të gjitha

1 komunikatat janë shkruar në Kosovë dhe, nëse duhet bërë një
2 falje lidhur me Komunikatën 59, duhet bërë me ndershmëri dhe
3 jo, siç thotë shprehja popullore, 'të hedhës gurin e të
4 fshehësh dorën'."

5 Tani, e kishit dëgjuar ju për reagimin e Jakup Krasniqit
6 ndaj faljes që ka bërë Hashim Thaçi?

7 PË. Unë nuk e kam dëgju, po u përcjell, u përcjell që i ka
8 thënë këto fjalë Jakup Krasniqi dhe ka bërë shumë mirë. Edhe e
9 falënderoj shumë. Ndiem mirë me të dhe ka bërë mirë që ka thënë
10 që nuk është e vërtetë. Kështu duhet me fol Jakup Krasniqi me
11 thënë të vërtetën, jo me rrejt si përpara ashtu. Faleminderit,
12 Jakup për këtë deklaratë që ke dhënë qysh është realitet. Edhe
13 për komunikata të tjera me tregu kush është ai që i ka shkru
14 komunikatat edhe dëmet që i kanë bërë shqiptarisë ato komunikata
15 të rrejshme, i kanë përzi me bashkëpunëtorë të Serbisë
16 njerëzit ma të mirë, presidentin, atë ministrin Ahmet
17 Krasniqi. Shumica janë vra.

18 PY. Dëshmitar, a mund të na sqarosh, e kuptova drejt, që nuk
19 e dëgjuat këtë postim të *Facebook* apo po thoni se e dëgjuat
20 Jakup Krasniqin?:

21 PË. Jo, nuk e kam ndëgju po është fol që ka fol Jakup
22 Krasniqi kështu në TV. Edhe shumë herë ka fol të vërtetën,
23 bukur i vërtetë, po shumë herë vetë, me qëllim sigurisht e ka
24 shtrembru. Kësaj radhe ka thënë një të vërtetë edhe të
25 falemnderit. Qështu duhet me fol. E vërteta është në interes

1 tonë, Jakup e ju shokë tjerë, me fakte këtu, bash unë jam këtu
2 me fol me fakte, jo me rrena.

3 Z. PACE: [Përkthim] Kërkojmë të pranohet ky dokument dhe
4 përkthimi.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
6 kundërshtim.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali
9 U16138 deri në U61381 që është postimi nga *Facebook* pranohet.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të dy versionet do të
11 marrin numrat P01751. Klasifikimi aktual është konfidencial.

12 Z. PACE: [Përkthim] Mund të bëhet publik.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të
14 riklasifikohet si publik.

15 Z. PACE: [Përkthim] Dokumenti mund të hiqet.

16 PY. Dëshmitar, Ramë Bujën e njif?

17 PË. Po, e njoh shumë mirë. Kemi punu bashkë në LDK. Bashkë
18 kemi punu nëntë vjet.

19 PY. Në 1998 dhe 1999 ka qenë anëtar i UÇK-së?

20 PË. Po.

21 PY. E dini se çfarë roli apo pozite ka pasur në UÇK ai?

22 PË. Unë nuk e di, po edhe sot e kam një vlerësim se nuk i di
23 ato punët e atyre çfarë i kam pas. Hiç s'jam marrë me to. Veç
24 e di që Ramë Buja ka qenë një njeri i mençur, një që kam pas
25 respekt, bile në daç me dit më i mençmi prej krejt grupës tyne

1 ka qenë Ramë Buja, që ka pas mend, ka pas tru.

2 PY. Ke folur ndonjëherë me Ramë Bujën për Komunikatën 59?

3 PË. Po, kam fol. Kam fol në mandatin e parë të deputetit unë
4 edhe ai. I kam thënë do fjalë Ramë Bujës, "Ik", thashë, "se
5 s'je kurrëgjë ti. Je ka aty s'ke fol për neve që na ke njoft
6 mirë". Më ka marrë prej dore edhe më ka shti në sallën e
7 nënkryetarit të kuvendit, të parlamentit të Kosovës, ka qenë
8 nënkryetari i parlamentit tha "Kam me të thënë diçka". Edhe më
9 ka thënë "Kam fol, ju kam thënë moni, se po gaboni edhe nuk më
10 kanë ngu. Keni pas pasoja ju, po edhe unë kam pas pasoja që ju
11 kam mbrojt juve".

12 Ai e din. Ma ka thënë mu këtë drejtpërdrejt. Edhe -- po.

13 PY. Ju thatë që kjo ndodhi gjatë mandatit të parë si deputet.

14 PË. Po.

15 PY. Në ç'vit ka qenë?

16 PË. Kjo 2002. 2002 qatë kohë se unë -- fillimet.

17 PY. Dëshmitar, ke dëgjuar ndonjëherë për vëllezërit Berisha
18 që njiheshin me emrin vëllezërit Lutani?

19 PË. Po, kam dëgju dhe për ta.

20 PY. Ke dëgjuar ndonjë gjë të veçantë për ta në vitet 1998 apo
21 1999?

22 PË. Kam dëgju që e kanë hup lidhjen me popullin e Kosovës dhe
23 nuk janë kanë në vijën e Zotit.

24 Z. PACE: [Përkthim] A mund të paraqisni në ekran

25 dokumentin SPOE00313999 deri në SPOE00313999 bashkë me shqipen

- 1 që kanë të njëjtën numër ERN por në fund ka një -ET.
- 2 Zmadhojeni pak shqipen.
- 3 PY. Siç e shikoni, Dëshmitar, është një komunikatë e Shtabit
4 të Përgjithshëm, Komunikata 80 dhe shohim data është 23
5 qershor. Këtë dokument e keni parë përpara sesa unë t'jua
6 tregoja javën që shkoi?
- 7 PË. Unë nuk e kam pa si dokument, po e di se ne i kem -- ju
8 tregova që pej 63,000 banorëve, tri familje kanë qenë në
9 program out, jashtë popullit tonë. Jo familje, po mund të them
10 tani individë edhe më pak se jo familje e gjanë, po individë
11 që e kanë mendu që nuk ka rrugë tjetër veç me Serbi.
- 12 PY. Edhe pse s'e keni parë përpara këtë komunikatë, a ju ka
13 qëlluar të dëgjoni se ka pasur një komunikatë për këta
14 vëllezër?
- 15 PË. Po, po, po. Thashë, unë e përmblodha ato ça dashta me
16 thënë rreth kësaj familje, jo familje e gjënë, po individë
17 edhe ajo me u ngushtu dy-tre individë, se është një rreth i
18 gjënë i atij mesi që nuk janë dashtë të gjithë.
- 19 PY. Që të jemi të qartë, nuk e ke parë përpara.
- 20 PË. Jo.
- 21 PY. Po ke dijeni se ka pasur një --
- 22 PË. Po, po, e vërtetë.
- 23 PY. -- një komunikatë me këtë përmbajtje?
- 24 PË. E vërtetë.
- 25 PY. Këtu në rreshtin e parë shohim që:

1 "Shërbimi i Inteligjencës së Zonës Operative të Drenicës
2 ka informacion të padiskutueshëm se deri në 1995, Sami dhe
3 Vehbiu dhe Gani Lutani ka bashkëpunuar me shërbimet sekrete
4 jugosllave dhe më vonë me shërbimin sekret të ushtrisë
5 jugosllave në Kosovë."

6 Keni dëgjuar juve që në 1998 apo 1999 vëllezërit Lutani
7 kanë qenë bashkëpunëtorë të autoriteteve serbe apo të
8 autoriteteve jugosllave?

9 PË. Unë e dhashë mendimin. Nuk di a ka nevojë edhe një herë.
10 Jashtë popullit, jashtë populli ishte pro njënën anë ata ishin
11 dy-tre familje njëna në anë tjetër. Dy-tre individë se familje
12 është shumë.

13 PY. Paragrafi i dytë thotë te rreshti i tretë:

14 "...ata kërkoheshin nga UÇK-ja dhe në qershor të 1999 u
15 gjetën dhe u rrethuan nga policia ushtarake... U bënë thirrje
16 të dorëzoheshin por ata hapën zjarr dhe si rezultat u vra
17 Vehbi dhe Ganiu, kurse Samiu Lutani është akoma person i
18 kërkuar. Dy nga policët u plagosën."

19 Mesa dini ju, Dëshmitar, është e saktë të thuhet se dy
20 nga vëllezërit Lutani u vranë gjatë një shkëmbimi zjarri me
21 policinë ushtarake të UÇK-s --

22 PË. Unë nuk kam --

23 PY. -- në qershor 1999, siç thuhet në këtë material?

24 PË. Siç thuhet në këtë, kjo është e vërtetë, po nuk kam
25 lidhje për ato kush, çka e qysh. Po tregova qysh kanë qenë e

1 ça kanë qenë. Me më vet mu unë kisha vepru ndryshe.

2 PY. Dëshmitar, e shikon që këtu përmendet KosovaPress në këtë
3 dokument?

4 PË. Po.

5 PY. Po ta shikosh pak në anën e majtë në shqip?

6 PË. Po, po.

7 PY. Në intervistën që i dhatë ZPS-së ju thatë që KosovaPress
8 u krijua në të njëjtën ditë apo një ditë më pas pasi u vra
9 Enver Maloku. Dhe se Shtabi i Përgjithshëm, siç e quante
10 veten, drejtohej, pra, nga Shtabi i Përgjithshëm. Është e
11 saktë që drejtohej nga Shtabi i Përgjithshëm?

12 PË. Po.

13 PY. Siç pretendonin?

14 PË. Është e vërtetë ajo krejt çka kam thënë, është e vërtetë
15 dhe çka po them dhe sot që tash qetu para juve. Qashtu është.
16 Është vra një njeri që ka kontribue sa krejt komplet na për
17 UÇK-në e për shqiptarinë, Enver Maloku. Një ditë përmbas u dal
18 radio -- kjo KosovaPress, që është mirë që u dal kjo po u
19 dashtë me kanë edhe ai edhe kjo.

20 PY. Që të jemi të qartë, e pranoj përgjigjen tuaj dhe kërkoj
21 që të pranohet si provë materiale.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
23 kundërshtim?

24 Z. DIXON: [Përkthim] Po, kundërshtojmë. Ju më parë keni
25 dhënë vendim lidhur me mocionin e paraqitur nga ZPS-ja në 27

1 korrik 2023 se ky dokument nuk duhet të pranohet sepse i
2 mungojnë treguesit e zakonshëm që të japin mundësi. Trupi
3 Gjykues të verifikojë autenticitetin e tij *prima facie*.

4 Pra, mesa kuptoj unë është i njëjti dokument, pa
5 shpjeguar më tej se cili është burimi apo origjina e tij.

6 Ky dëshmitar nuk ka mundur t'i identifikojë që ky ka
7 qenë, që ky dokument ka qenë komunikata që ka parë. Atëhere ka
8 thënë që ka dijeni në përgjithësi. Dhe ai jep dëshmi sigurisht
9 për thelbin e vrasjeve të pretenduara të cilat nuk janë të
10 listuar në aktakuzë dhe kjo duhet marrë parasysh.

11 Po kundërshtimi i parë që kemi ka të bëjë me
12 autenticitetin e dokumentit i cili nuk është vërtetuar
13 nëpërmjet arkivës së internetit. Dhe ju kërkohet që të lini në
14 fuqi vendimin tuaj të parë se i mungon autenticiteti *prima*
15 *facie* dhe ta shënoni vetëm për qëllimi identifikimi në qoftë
16 se do të ketë ndonjë provë të mëtejshme lidhur me rëndësi për
17 autenticitetin do ta vlerësoni kur të vijë koha.

18 Z. ELLIS: [Përkthim] Edhe neve i bashkohemi me këtë
19 kundërshtim.

20 Z. PACE: [Përkthim] Qëllimi pse e përdorëm këtë dokument
21 është për shkak të kundërshtimit, meqë siç thatë juve, i
22 mungon, nuk kishim mundësi të vërtetonim autenticitetin.

23 Por ai dha dëshmi lidhur me entitetin, pra, KosovaPress
24 që e ka botuar këtë dokument, që duket se ka qenë pika që ju,
25 arsyeja pse ju nuk e pranuat.

1 Përmbajtja e artikullit lidhet me atë që ne kemi qëllim,
2 pra, për qëllimet e zakonshme penale.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta
4 shënojmë për identifikim. Dhe për sot mbaroj.

5 Dëshmitar, me ju mbaruam sot por duhet të vini përsëri
6 nesër në orën 9.00. Mos flisni me askënd jashtë sallës së
7 gjyqit për dëshminë tuaj. Në qoftë se dikush përpigjet të flasë
8 me ju për dëshminë tuaj këtu, na njoftoni.

9 Ju urojmë ta kaloni mbrëmjen sa më mirë. Shihemi nesër.

10 DËSHMITARI: Faleminderit.

11 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

12 Z. PACE: [Përkthim] Sa për t'ju dhënë përditësimin nga
13 ana jonë lidhur me kohën, do të na duhet dhe nja 15 minuta
14 nesër.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'jua
16 japim këto 15 minuta nesër.

17 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
18 këshillohen]

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] për t'i dhënë numrin
20 MFI dokumentit, numri është SPOE00313999 dhe përkthimi i tij
21 në anglisht që do të marri numrin P01752. Klasifikimi është
22 publik.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë gjë që
24 doni ta ngrini në këtë çast?

25 A mund të më përditësoni lidhur me ndonjë ndryshim nga

1 ana juaj lidhur me kohëzgjatjen e pyetjeve nga ana juaj?

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo.

3 Z. DIXON: [Përkthim] Ne e ulëm kohën që kërkojmë shumë.

4 Z. ROBERTS: [Përkthim] Neve nuk kemi bërë asnjë ndryshim,
5 pra, që na duhen 45 minuta.

6 Z. ELLIS: [Përkthim] Besoj një orë e gjysëm.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prokurorit do
8 t'i japim 15 minuta.

9 Do takohemi nesër në orën 9.00.

10 --- Seanca mbyllet në orën 16.34

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25